



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Mësuesi për arsimin parashkollor”

Kolegji Universitar “LOGOS”

Grupi i vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc.Dr.Robert GJEDIA

Prof.Asoc.Dr. Leticja GUSHA

Nëntor / 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Mësuesi për arsimin parashkollor"**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "Logos"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në Mësuesi për arsimin parashkollor
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 432, datë 20.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Shkollat e GJGJ
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Diplomë për arsimin parashkollor
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Kolegji Universitar "Logos"
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	15 PAE / 8 PAK
18	Numri i studentëve:	14 studentë
19	Komente / të tjera:	

Nëntor

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm, duke u bazuar në rradhë të parë në aktivitetet e realizuara sipas agjendës së miratuar nga dy institucionet, është realizuar në kuadrin e akreditimit të programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Mësuesi për arsimin parashkollor", kërkuar nga IAL, Kolegji Universitar "LOGOS" Tiranë.


Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet që kanë dalë si rezultat i analizës për procesin e vlerësimit të jashtëm. Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit me kohë të plotë i ciklit të parë me emërtesë "Bachelor" në: "Mësuesi për arsimin parashkollor" i ofruar nga Departamenti i Pedagogjisë-Psikologjisë. Ky departament është pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane dhe të Komunikimit Gjuhësor të KU "LOGOS", Tiranë.

Programi është licencuar me UMASR nr.432, datë 20.07.2018, ", i cili realizohet me 180 kredite, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra). Programi i studimit nuk ka kaluar më parë proces akreditimi.

Numri i studentëve të regjistruar në këtë program ndër vite ka qenë:

- Për vitin akademik 2020-2021 është 6 studentë;
- Për vitin akademik 2019-2020 është 3 studentë;
- Për vitin akademik 2018-2019 ka qënë 5 studentë;

Ky program studimi akreditohet për herë të parë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Metodologjia e përdorur për realizimin e vlerësimit të jashtëm

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm ka qënë identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr.531, datë 11.09.2018, për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor”.

ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Kolegji Universitar “LOGOS” Tiranë, për të realizuar takimet në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof.Asoc. Dr.Robert Gjedia dhe Prof.Asoc. Dr. Leticja Gusho. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua edhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Msc. Majlinda Demirneli.

Baza ligjore mbi të cilin është mbështetur procesi i vlerësimit të jashtëm është:

- Ligji nr.80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Urdhër i MASH nr.81, datë 25.02.2013;
- VKM nr.531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”;
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017;

Aktivitetet kryesore të realizuara

Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar disa aktivitete. Kështu, është realizuar analiza e të dhënave parësore dhe dytësore.

Analiza e të dhënave parësore. Të dhënat parësore janë ekstraktuar nga:

- raporti i vlerësimit të brendshëm për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” (2021) i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm;
- statuti i Kolegjit Universitar “LOGOS”, Tiranë;
- rregullore e përgjithshme e Kolegjit Universitar “LOGOS”, Tiranë;
- rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor;
- paketa e plotë e dokumentacionit të programit depozituar në platformën AMS të ASCAL;
- programet lëndore;
- dokumentacione të tjera administrative, siç është dokumentacioni i personelit;


Analiza e të dhënave dytësore. Kjo analizë u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara në institucionin e Kolegjit Universitar Logos, në data 15 dhe 16 Korrik 2021. Si rezultat i shtrirjes së efektit të Pandemisë prej COVID-2019, gjatë gjithë kohëzgjatjes së vizitave në insitucion, u respektua zbatimi i protokollit të përcaktuar nga Komisioni Teknik i Ekspertëve në Republikën e Shqipërisë, si edhe nga aktet normative në fuqi, për të gjitha vizitat e planifikuara në ambjentet e institucionit të Kolegjit Universitar “LOGOS” Tiranë (Fakultetit të Shkencave Humane, Departamentit të Edukimit). Takimet sipas agjendës së paracaktuar dhe të dakordësuar nga të dy institucionet janë zhvilluar në datat 15 dhe 16 Korrik 2021. Gjatë këtyre takimeve u zhvilluan bashkëbiseda të qëllimta dhe vëzhgime. Kështu, u realizuan biseda

të drejtuara me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, me Përgjegjësin e Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë, si edhe me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”. Gjithashtu, më pas u realizuan biseda me stafin akademik të programit të studimit, me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional, me përfaqësues të Zyrës së marrëdhënieve me jashtë, promovimeve/këshillimit të karrierës, me përfaqësues të sekretarisë mësimore, me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, Protokollit dhe Arkivave, si edhe intervista me studentët e programit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, si edhe u mundësua vëzhgimi nga afër i mjediseve (auditorëve, atelie, bibliotekës, si edhe shërbimet për studentët etj.). Në përfundim të takimeve në ditën e dytë, u zhvillua edhe takimi përmbyllës me përgjegjësin e Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë.

Vëzhgimi i mjediseve

Siç u cilësua më sipër, ndonëse në kushtet e pandemisë prej COVID-19, vizitat në institucion janë realizuar në prezencë fizike duke respektuar mbajtjen e distancës fizike. Stafi i Kolegjit Universitar “LOGOS”, Tiranë, i angazhuar për këtë proces, ka patur gjatë gjithë kohës një përkushtim maksimal për t’i siguruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të gjithë elementët e nevojshëm dhe të duhur për mbledhjen e të dhënave. Duke u mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime është hartuar dhe raporti i vlerësimit të jashtëm.

Kolegji Universitar “LOGOS”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 26.10.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 9 / 27 Prot, datë 26.10.2021. Kolegji Universitar “LOGOS”, përcjell në ASCAL, me anë të shkresës me Nr. 25/1 Prot, datë 02.11.2021, “Përgjigje tuajës 9/27, datë 26.10.2021, lidhur me dërgimin e draft raportit të vlerësimit të jashtëm”, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”

I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Veprimtaria e Kolegjit Universitar “LOGOS” bazohet kryesisht në:</p> <ul style="list-style-type: none">– Ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;– Aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;– Dokumentet bazë rregullatore të institucionit si Statuti i KU “LOGOS”, planet strategjike të miratuara, si edhe në dokumentet e tjera rregullatore të lidhura me to. <p>Në nenin 3 të Statutit¹ të KU “LOGOS” theksohet se misioni i Kolegjit është që <i>“të kontribuojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe të interesave të zhvillimit të vendit”</i>, ndërsa në po këtë nen, theksohet se <i>“traditat më të mira morale, kulturore, arsimore dhe shkencore të vendit, janë baza e mësimdhënies dhe e kërkimit shkencor, të ndërthurrura me standardet dhe arritjet më të mira ndërkombëtare në përgjithësi dhe ato europiane në veçanti”</i>. Gjithashtu, nga kqyrja e kujdesshme e të gjitha dokumentave rregullatore që janë në bazë të veprimtarisë së KU “LOGOS”, vihet re të gjitha këto dokumente janë të hartuara në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, si edhe në përputhje me legjislacionin specifik që rregullon marrëdhëniet në fushën e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor.</p>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar nga Institucioni konstatohet se, programi i Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” në programin të tij, midis të tjerash parashikon edhe zhvillimin e lëndëve Gjuhë Shqipe & Didaktikë, Etikë, Edukim Qytetar, Njohuri për Gjeografinë, etj. Përmes zhvillimit dhe zbatimit të programit të plotë mësimor², synohet <i>përgatitja e specialistëve të lartë në fushën e arsimit parashkollor në përputhje me prioritetet e zhvillimit të arsimit dhe edukimit socialo-kulturor të vendit tonë</i>. Ndërsa në objektivat kryesore të Programit të Studimit³ theksohet <i>pajisja e studentëve me konceptet dhe teoritë themelore në fushën e edukimit parashkollor, si edhe krijimi i një lidhje sa më harmonike</i></p>

¹ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 2, Statuti i KU “LOGOS”, ASCAL, Dok. nr.13. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

² Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 13, Dosja e plotë e Programit të Studimit me elementët përbërës të tij", ASCAL, Dok. nr.26. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

³ Ibid

	<p><i>ndërmjet teorisë që do të merret në auditor, praktikave të avancuara në "ateliënë model" në mjediset e kolegjit universitar.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Në nenin 3 të Statutit të Institucionit⁴, theksohet se misioni i Kolegjit është <i>zhvillimi i dijeve përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të ngritura në nivel bashkëkohor si edhe kontribuimi në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit.</i> Ndërsa në nenin 4 të Statutit të KU "LOGOS" theksohet se Kolegji gëzon liri akademike për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e kërkimit shkencor. Mënyra e ndërtimit dhe frazeologjia e përdorur në hartimin e statutit, i jep KU "LOGOS" shkallën e nevojshme të lirisë dhe të fleksibilitetit për të hartuar dhe ofruar ato programe studime që janë me interes për të, gjithmonë në kuadër të legjislacionit shqiptar që rregullon marrëdhëniet në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.</p> <p>Programi i Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" mbulohet nga Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, në përbërje të të cilit ka qënë edhe Departamenti i Mësuesisë për Arsimin Parashkollor⁵. Në vitin 2020, emërtimi i këtij departamenti është ndryshuar në Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë, emërtim që ruhet edhe sot.</p> <p>Në Statutin e KU "LOGOS" nuk përmendet shprehimisht fakti se cilat cikle studimore ofron institucioni referuar Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Vetëm në rregulloren e FSHHKGJ⁶, në nenin 9 përmendet në mënyrë të përgjithshme se <i>Programet e studimeve hartohen nga njësitë bazë të fakultetit dhe miratohen në senatet akademike, ato hartohen referuar nivelit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.</i> Nisur nga gjendja faktike, Programi i Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" i ofruar nga KU "LOGOS" i referohet nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Sipas Statutit të Institucionit, KU "LOGOS" ka për mision:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të zhvillojë dijet, përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor, në të mirë të përgatitjes me nivel bashkëkohor të studentëve; - të kontribuojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit; - të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor; <p>Ndërsa në nenin 4 të Rregullores së FSHHKGJ⁷, theksohet se misioni i këtij fakulteti është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor;

⁴ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 2, Statuti i KU "LOGOS", ASCAL, Dok. nr.13.

Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁵ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor", ASCAL, Dok. nr.18. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁶ Ibid

⁷ Ibid

	<ul style="list-style-type: none"> - të formojë specialistë të lartë në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit; - të krijojë mundësi për aftësimin shpirtëror dhe edukues të studentit;⁸ <p>Në Planin Strategjik të KU "LOGOS" për vitet 2018-2024 theksohet se KU "LOGOS" ofron programe studimi në përputhje me tendencat e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar⁹. Gjithashtu, në këtë plan strategjik, theksohet se qëllimi i KU "LOGOS" është t'u ofrohet studentëve një përvojë arsimore që u ofron atyre mundësinë për të përmbushur potencialin e tyre si individë, duke u zhvilluar brenda komunitetit tonë si studentë të pavarur, të përgatitur për të marrë përgjegjësinë për zhvillimin e tyre personal dhe profesional gjatë gjithë jetës së tyre. Konstatohet se Programi i Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", i bazuar në dokumentet kryesore, rregullatore të KU "LOGOS", synon përgatitjen e specialistëve të lartë që të jenë të aftë të konkurrojnë si në tregun lokal të punës, ashtu edhe në atë kombëtar.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Në strategjinë e KU "LOGOS" theksohet se objektivi i parë i tij është transformimi nga <i>Kolegj</i> në <i>Universitet</i> për të përmbushur vizionin dhe misionin e institucionit. Për këtë, synohet riformësimi i strukturës institucionale për të përmbushur vizionin dhe misionin e fokusuar në fushën e biznesit, humanizmit, <i>arsimit</i> , teknologjisë së komunikimit, shëndetësisë dhe mirëqenies dhe agrobiznesit, bazuar në studimin e tregut. ¹⁰ Në Planin e Zhvillimit Strategjik ¹¹ të Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë, është vendosur si objektivi shpalosja e një oferte cilësore dhe konkurruese për tregun e punës dhe nevojat e vendit, me individë të kualifikuar, të gatshëm për sektorin publik dhe atë privat. Konkludohet se Programi i Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" ofrohet në përshtatje të plotë me

⁸ Ibid

⁹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 3, Plani Strategjik i Zhvillimit të KU "LOGOS" ", ASCAL, Dok. nr.14. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>


¹⁰ Kolegji Universitar "LOGOS", "Aneksi 3, Plani Strategjik i Zhvillimit të KU "LOGOS" ", ASCAL, Dok. nr.14. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹¹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 4.1, Draft Plani Strategjik i Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë ", ASCAL, Dok. nr.16. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	dokumentet rregullatore të Institucionit dhe me planet strategjike të miratuara në nivel institucioni dhe në nivel njësie bazë.			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Siç është theksuar edhe në komentimin e standardit I.1 (kriteri 3), misioni i Kolegjit është <i>zhvillimi i dijeve përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të ngritura në nivel bashkëkohor si edhe kontribuimi në mbështetje të prioritetëve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit</i> . Ndërsa në nenin 4 të Statutit të KU “LOGOS” theksohet se Kolegji gëzon liri akademike për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e kërkimit shkencor. Mënyra e ndërtimit dhe frazeologjia e përdorur në hartimin e statutit, i jep KU “LOGOS” shkallën e nevojshme të lirisë dhe të fleksibilitetit për të hartuar dhe ofruar ato programe studime që janë me interes për të, gjithmonë në kuadër të legjislacionit shqiptar që rregullon marrëdhëniet në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	KU “LOGOS”, nisur nga dokumentet rregullatore të miratuara prej organeve drejtuese të tij, synon formimin e specialistëve në fushat e biznesit, humanizmit, <i>arsimit</i> , teknologjisë së komunikimit, shëndetësisë dhe mirëqenies dhe agrobiznesit, bazuar në studimin e tregut. Nisur nga këto synime, si edhe nga shkalla e lirisë akademike që është sanksionuar në Statutin e Institucionit, Programi i studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” i ofruar nga KU “LOGOS” është në përputhje me drejtimit kryesore akademike të institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Në Rregulloren e Programit të Studimit ¹² për “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, theksohet se <i>misioni</i> i programit të studimit “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është: <ul style="list-style-type: none"> – të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor; – të formojë specialistë të lartë në fushën e arsimit parashkollor në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit; – të krijojë mundësi për aftësimin metodik, pedagogjik dhe edukues të studentit; Misioni synon formimin e aftësive teoriko-shkencore, shprehive praktike, psiko-pedagogjike, gjuhësore, për arritjen e standardeve të

¹² Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimit “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




	<p>larta në mësimdhënie, të cilat do të sigurojnë një përvehtësim aktiv të dijeve dhe përmbushin objektivat e arsimit parashkollor në shoqërinë e dijes. Rezultatet kryesore të pritshme të të nxënit të Programit të Studimit Bachelor në: “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, për studentët që përfundojnë me sukses programin, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojnë konceptet themelore në fushën e edukimit parashkollor; - të reflektojnë mbi filozofinë e edukimit tradicional dhe atë të avancuar me “në qendër fëmija”; - të njohin dhe kuptojnë procesin e edukimit parashkollor, familjar dhe parashkollor të institucionalizuar; - të reflektojnë për vlerat e edukimit parashkollor në shoqëri, dhe forcojnë partneritetin prindër-fëmijë dhe komunitet-fëmijë; - të formojnë një filozofi personale të avancuar për edukimin parashkollor; <p>Programi i studimit Bachelor në: “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” synon të formojë specialistë në fushën e arsimit parashkollor, më konkretisht ky program përgatit edukatorë me aftësi profesionale në rritje, që të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të jenë përgjegjës ndaj fëmijëve, të bashkëveprojnë me fëmijët duke demonstruar dashuri dhe respekt; - të inkurajojnë fëmijët të përdorin gjuhën si mjet komunikimi, të krijojnë mundësi për inkurajimin e bashkëveprimit fëmijë-fëmijë; - të inkurajojnë pavarësinë e fëmijës sipas moshës dhe zgjedhjeve të zhvillimit; - të jenë të aftë të nxisin motivimin e brendshëm për t’i ndihmuar fëmijët të njohin botën që i rrethon, të fitojnë njohuri, aftësi dhe vlera; <p>Rezultoni se Rregullorja e Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” ka të përcaktuara qartë synimet, objektivat, si edhe kompetencat që duhet të fitojnë studentët pas përfundimit me sukses të këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve</p>	<p>Sipas dokumenteve shkresore të pasqyruara në RVJ, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor është krijuar sipas Urdhrit nr.408, datë 13.07.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Gjithashtu, në përbërje të këtij fakulteti është edhe Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë. Programi i studimit Bachelor në: “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” i ofruar nga ky departament, është miratuar në bazë të Urdhrit nr.432 datë 20.07.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Përpara hapjes dhe miratimit të Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për arsimin parashkollor”, rezultoni se Institucioni ka kryer një studim të tregut¹³, duke përdorur instrumente të ndryshme sonduese. Gjithashtu, Kolegji</p>

¹³ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 15, Studim për tregun e punës para hapjes së programit", ASCAL, Dok. nr.28. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



<p>të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Universitar “LOGOS” është në pronësi të Fondacionit “LOGOS”, i cili nga ana e tij zotëron një rrjet kopshtesh parashkollorë të shtrirë në gjithë territorin e vendit. Në këto kushte, nisur nga studimi i përgjithshëm i tregut, por edhe nga nevojat specifike për specialistë të lartë të arsimit parashkollor, si në fushën private ashtu edhe në atë publike, për ligjet plotësisht hapja dhe vazhdimësia e zhvillimit të Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për arsimin parashkollor”. Në KU “LOGOS” funksionon edhe Zyra e Çështjeve Studentore dhe e Këshillimit të Karrierës¹⁴, e cila ka për mision:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të rrisë puneshmërinë e studentëve; - të shërbejë për një përjasje më të mirë të studentëve me tregun e punës; <p>Ndërsa qëllimi i zyrës është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - rritja e numrit të studentëve që punësohen; - krijimi i lidhjeve me punëmarrësit potencialë; - njohja me tregun e punës nga pikëpamja e kërkimit të punës së dëshiruar; <p>Për shkak të pandemisë të shkaktuar nga Covid-19, por edhe për shkak të kohës së shkurtër prej fillimit të ofimit të programit të studimit (programi ka filluar në vitin 2018), mbetet sfida e hapur në të ardhmen realizimi i detyrave dhe përgjegjësi që ka marrë përsipër Zyra e Çështjeve Studentore dhe e Këshillimit të Karrierës.</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Siç është përmendur edhe në komentin e Standardit I.3.1, rezultatet kryesore të pritshme të të nxënit të programit të studimit “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, për studentët që përfundojnë me sukses programin, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojnë konceptet themelore në fushën e edukimit parashkollor; - të reflektojnë mbi filozofinë e edukimit tradicional dhe atë të avancuar me “në qendër fëmija”; - të njohin dhe kuptojnë procesin e edukimit parashkollor, familjar dhe parashkollor të institucionalizuar; - të reflektojnë për vlerat e edukimit parashkollor në shoqëri, dhe forcojnë partneritetin prindër-fëmijë dhe komunitet-fëmijë; - të formojnë një filozofi personale të avancuar për edukimin parashkollor; <p>Për të përmbushur arritjen e këtyre rezultateve të nxënit, në planin mësimor të Programit të Studimit janë përfshirë lëndë teorike, lëndë të natyrës praktike, si edhe praktika profesionale. Gjithashtu, në</p>

¹⁴Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 12, Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve studentore dhe këshillimit të karrierës”, ASCAL, Dok. nr.25. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



	ndihmë të studentëve, shërben edhe Tutori Akademik ¹⁵ , detyrat kryesore të të cilit janë: <ul style="list-style-type: none"> - orientimi dhe këshillimi i studentëve përgjatë programit të studimit; - bërja e studentëve bashkëprotagonistë të procesit formues; - heqja e pengesave të mundshme në mësimdhënien e lëndëve, duke u ofruar një metodë studimi studentëve të cilëve u mungon; - favorizimi i hyrjes së studentëve në tregun e punës; 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Programi i Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” i ofruar nga KU “LOGOS” zbatohet nga një staf kryesor akademik dhe staf ndihmës, i cili është një kombinim brezash, kulturash, si edhe përvojash të shumëllojta¹⁶. Në staf ka pedagogë me përvojë të gjatë në fushën e mësimdhënies që kanë marrë shkollim bazë në Shqipëri dhe që janë specializuar jashtë vendit. Gjithashtu, në përbërje të stafit janë edhe personel akademik me shkollim tërësisht përëndimor, me jetëshkrime dhe specializime të shumta dhe të shumëllojshme, që mbartin mbi vehte përvojë të pasura shumëvjeçare. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, për vitin akademik 2020-2021 ka gjithsej 63 pedagogë, nga të cilët 36 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 3 kanë titullin “Profesorë”, 6 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 10 kanë gradën Dr. dhe 17 Asistent Lektorë me Msc, dhe 27 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 7 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 12 kanë gradën Dr. dhe 8 Asistent Lektorë me Msc¹⁷.</p> <p>Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit në këtë vit akademik, sipas evidencës¹⁸, rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie 23 pedagogë gjithsej, ku 15 PAE, nga të cilët 1 Prof.Dr, 3 Prof.asoc, 3 me gradën Dr, si edhe 8 asistente-lektore me Msc, dhe 8</p>

¹⁵ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 31.3, Praktikë e procesit të udhëheqje-kujdestari (tutorat), për studentët e KU-LOGOS”, ASCAL, Dok. nr.52. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁶ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 17, CV e stafit akademik”, ASCAL, Dok. nr.33. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁷ Kolegji Universitar “Logos”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 18, Tabela 1.3. Numri i personelit akademik në njësinë përgjegjëse”, ASCAL, Dok. nr.34. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>


¹⁸ Ibid

	<p>PAK nga të cilët, 2 Prof.Asoc, 4 me gradën Dr, si edhe 2 asistente-lectore me Msc.</p> <p>Duhet sjellë në vëmendje, referuar dhe Raportit të Vlerësimit të Brendshëm që ka dorëzuar institucioni faqe 21, 22, 23¹⁹, se për shkak të numrit të ulët të studentëve, KU “LOGOS” ka marrë miratimin e MASR²⁰ dhe është pranuar që numri minimal i personelit akademik me kohë të plotë për DPP të jetë 5, nga të cilët dy prej tyre të kenë gradë apo titull shkencor dhe se personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë, për çdo rast, jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore.</p> <p>Aktualisht, për vitin akademik 2020-2021, DPP i KU “LOGOS”, përgjegjës për zbatimin e Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ka në përbërje të tij 6 (gjashtë) personel efektiv akademik, nga të cilët 4 (katër) janë me tituj/grada shkencore.</p> <p>Për një funksionim sa më cilësor të Programit të Studimit dhe gjithashtu në përputhje me legjislacionin në fuqi, KU “LOGOS” për të kompensuar këtë element, ka angazhuar edhe 9 (nëntë) pedagogë të tjerë, pjesë të personelit PAE, që e zhvillojnë jetën akademike brenda KU “LOGOS”, me përbërje si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 anëtarë me titullin Profesor i Asociuar; - 1 anëtar me gradën Doktor i Shkencave; - 2 anëtarë në proces doktore; - 4 anëtarë me gradën Master i Shkencave²¹; <p>Si rrjedhojë, burimet njerëzore dhe infrastrukture janë të mjaftueshme për zhvillimin në normalitet të procesit mësimor, si edhe ka një qëndrueshmëri të kuadrit akademik dhe një raport të përshtatshëm midis brezave të ndryshëm të personelit akademik.</p> <p><i>Rekomandohet që Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë, referuar edhe VKM nr. 418, datë 10.5.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”, të plotësojë të paktën numrin minimal prej 7 PAE.</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas</p>	<p>Shqipëria është vend anëtar i UNESCO dhe çdo IAL është e detyruar që në të gjitha programet e ofruara të studimit duhet të ndjekë kodifikimet e kërkuara nga kjo agjenci. Kështu, sipas klasifikim/kodifikimit të kërkuar nga kjo agjenci (<u>Field Descriptions</u> (unesco.org), Shkenca e Edukimit në kuptimin më të gjerë mban kodin</p>

¹⁹ Kolegji Universitar “Logos”, FSHHKGJ, DPP, “03 RVB_BA_Mësuesi për Arsimin Parashkollor, (faqe 21, 22, 23)”, ASCAL, Dok. nr.4. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 46.2, Marrëveshje MAS, Reduktimi i numrit të personelit akademik në njësinë bazë”, ASCAL, Dok. nr.117. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²¹ Kolegji Universitar “Logos”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 18, Tabela 1.3. Numri i personelit akademik në njësinë përgjegjëse”, ASCAL, Dok. nr.34. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



<p>klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>01; në kuptimin e ngushtë Edukimi mban kodin 011; në kuptimin më të hollësishëm trainimi për mësues të ciklit parashkollor mban kodin 0112. Shkencat Humane dhe Artet, sipas këtij klasifikimi, në kuptimin më të gjerë mbajnë kodin 02; në kuptimin më të ngushtë Artet mbajnë kodin 021, Religion and Teology mban kodin 022, ndërsa gjuhët mbajnë kodin 023.</p> <p>Duket qartë se sipas këtij klasifikimi, Shkencat e Edukimit (me kod 01) klasifikohen me natyrë të ndryshme nga Shkencat Humane (me kod 02). Me këtë arsyetim, fusha e përgjithshme dhe specifike e Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” nuk është tërësisht në përputhje me fushën e përgjithshme dhe specifike të njësisë kryesore (Fakultetit të Shkencave Humane dhe të Komunikimit Gjuhësor). Kjo mospërputhje njihet edhe nga vetë organet drejtuese të KU “LOGOS”, e shprehur kjo në faqen 11 të Planit Strategjik të Zhvillimit të KU “LOGOS”²², sipas të cilit, në objektivin e parë kërkohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>“Të riformatohet struktura institucionale në përputhje me dokumentet e UNESCOs mbi Arsimin e Lartë, bazuar në ISCED Fushat e Arsimit dhe Trajnimit 2013 (ISCED-F 2013) dhe në klasifikimin ndërkombëtar të fushave të arsimit”;</i> <p><u><i>GVJ rekomandon:</i></u></p> <ol style="list-style-type: none"> <i>1. Ose që emërtimi i FSHHKGJ të bëhet: Fakulteti i Shkencave Humane dhe i Edukimit (pasi sipas UNESCO fusha e shkencave gjuhësore është pjesë e shkencave humane);</i> <i>2. Ose të krijohet Fakulteti i Edukimit (siç është parashikuar edhe në Planin Strategjik të Zhvillimit të KU “LOGOS” të përmendur më sipër në këtë pikë);</i> 				
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Siç u përmend në kriterin 2 të këtij standardi, fusha e përgjithshme dhe specifike e Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” nuk është në përputhje me fushën e përgjithshme dhe specifike të njësisë kryesore (Fakultetit të Shkencave Humane dhe të Komunikimit Gjuhësor).</p> <p>E njëjta gjë nuk mund të thuhet për njësinë bazë që zbaton Programin e Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”. Në këtë rast, njësia bazë është Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë në përbërje të FSHHKGJ. Për shkak se pedagogjia është një nga pjesët përbërëse të Fushës së Edukimit, mund të thuhet se fusha e përgjithshme dhe specifike e Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është në përputhje me fushën e përgjithshme dhe specifike të njësisë bazë (Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë).</p>				
	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="627 1861 842 1930">Nuk përmbushet</td> <td data-bbox="850 1861 1082 1930">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="1090 1861 1321 1930">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1329 1861 1517 1930">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

²² Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 3, Plani Strategjik i Zhvillimit të KU “LOGOS””, ASCAL, Dok. nr.14. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Shkalla e përmbushjes së standardit

X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret

Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.

Vlerësimi i ekspertëve

Rregullimi i jetës së brendshme si edhe veprimtaria e KU "LOGOS" rregullohet në mënyrë hierarkike përmes:

- Statutit të Institucionit;²³
- Rregullores së Përgjithshme të KU "LOGOS";²⁴
- Rregullores së FSHHKGJ;²⁵
- Rregullores së Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë;²⁶
- Rregullores së Programit të Studimit;²⁷

Rregullorja e Përgjithshme e KU "LOGOS" ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë mësimore-shkencore dhe administrative të Kolegjit Universitar "LOGOS" në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të tij dhe e shtrin vepriminë e saj mbi të gjitha njësitë përbërëse të këtij Institucioni, personelin akademik, personelin ndihmës akademik, personelin administrativ dhe studentët. Ajo disiplinon marrëdhëniet midis organeve drejtuese të shkallës së lartë me njësitë përbërëse dhe marrëdhëniet me të tretët. Rregulloret e brendshme të njësive kryesore, njësive bazë dhe organizmave akademike dhe drejtuese dhe strukturave organizative janë në pajtim me Rregulloren e Përgjithshme të Kolegjit Universitar "LOGOS"

Rregullorja e FSHHKGJ e shtrin fuqinë e saj mbi të gjitha njësitë përbërëse të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, personelin akademik, ndihmësakademik, personelin administrativ dhe studentët.

Rregullorja e DPP rregullon jetën e brendshme të njësisë bazë, si edhe mundëson komunikimin me strukturat e tjera të FSHHKGJ.

Rezulton se aktet e mësipërme rregullatore të KU "LOGOS", të përmendura më sipër, mundësojnë zhvillimin normal të veprimtarisë së tij dhe pavarësinë e degëve të tij, por edhe kontrollin dhe ekuilibrin e këtyre strukturave.

²³ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 2, Statuti i KU "LOGOS", ASCAL, Dok. nr.13. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁴ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 5, Rregullore e Përgjithshme e KU "LOGOS", ASCAL, Dok. nr.17. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁵ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor", ASCAL, Dok. nr.18. Parë në Gusht 2021, gjendet

²⁶ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6.1, Draft-Rregullore e DPP-së", ASCAL, Dok. nr.19. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁷ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimit "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Referuar RVB- së, KU “LOGOS” ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda e jashtë vendit, si edhe me aktorë të tjerë të institucioneve vendase e të huaja²⁸, me qëllim realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve. Ndër institucionet homologe të huaja, përmenden bashkëpunimet me Institucione të Arsimit të Lartë në Greqi, Finlandë, Maltë, Rumani.</p> <p>Gjithashtu, KU “LOGOS” ka vendosur edhe marrëdhënie bashkëpunimi me universitete analoge me qendër në Shqipëri, si edhe ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të tjerë vendas, publikë dhe privatë. Bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë shtetit konsiston në shkëmbimin e personelit akademik në kuadër të programit Erasmus+, si edhe në organizimin e konferencave të përbashkëta.</p> <p>Bashkëpunimi me aktorët vendas, publikë dhe privatë, konsiston kryesisht në shkëmbim të ekspertizës, shkëmbim informacioni për projekte të përbashkëta, si edhe mundësimin e kryerjes së praktikave profesionale.</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Informacione të hollësishme për realizimin dhe përfitimet e marra nga marrëveshjet e bashkëpunimit jepen në dokumentet e cituara më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raporte vjetore të DPP-së²⁹, Aneksi 29.1, Pika 8, <i>Informacion mbi bashkëpunimin ndërinstitutional</i>; - Raport Vjetor i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor 2018-2019³⁰, Aneksi 29.2, Pika 8; - Raport Vjetor 2018-2019³¹, Kolegji Universitar “LOGOS”, Aneksi 29.3, Pika V; - Raporti Vjetor 2019-2020³², Kolegji Universitar “LOGOS”, Aneksi 29.4, Pika B/e;
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Referuar RVB- së, Kolegji Universitar “LOGOS” ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës, me qëllim kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale të studentëve të Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë³³. Rrethi i aktorëve me të cilat Kolegji Universitar</p>

²⁸ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 27, Marrëveshjet e bashkëpunimit", ASCAL, Dok. nr.43. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁹ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.1, Raporte vjetore të DPP-së", ASCAL, Dok. nr.45. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

³⁰ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.2, Raport Vjetor i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor 2018-2019", ASCAL, Dok. nr.46. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

³¹ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.3, Raporti Vjetor 2018-2019, Kolegji Universitar LOGOS", ASCAL, Dok. nr.47. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

³² Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.4, Raporti Vjetor 2019-2020, Kolegji Universitar LOGOS", ASCAL, Dok. nr.48. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

³³ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 26, Tabela Nr.5, Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë", ASCAL, Dok. nr.42. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	“LOGOS” ka marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e ndërsjelltë të praktikave profesionale, përfshin institucione të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, çerdhe dhe kopshte të qyteteve të ndryshme, shoqata dhe fondacione të ndryshme, si edhe shkolla të niveleve të ndryshme publike dhe private.			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Ky program studimi në vitin akademik 2020-2021 nxjerr brezin e parë të studentëve të diplomuar. Megjithatë, Institucioni ka ngritur Zyrën e Çështjeve Studentore dhe të Këshillimit të Karrierës ³⁴ , misioni kryesor i të cilës është: <ul style="list-style-type: none"> - të rrisë punueshmërinë e studentëve; - të shërbejë për një përjasje më të mirë të studentëve me tregun e punës; Mbetet që të zbatohen në praktikë detyrimet që ka personeli i kësaj zyre kundrejt studentëve;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi II.1

Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Specifikimet për Programin e Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” jepen në dosjen e plotë të Programit të Studimit ³⁵ . Programi i studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është i organizuar në lëndë dhe module me gjithsej 180 kredite (ECTS) dhe me kohëzgjatje 3 vjet, i ndarë në mënyrë të barabartë me 60 kredite në një vit akademik. Programi i studimit i referohet nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe është në përputhje me nenet 69-73 të Ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si edhe me VKM nr.41, datë 24.1.2018

³⁴ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 12, Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve studentore dhe këshillimit të karrierës”, ASCAL, Dok. nr.25. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

³⁵ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 13, Dosja e plotë e Programit të Studimit me elementët përbërës të tij”, ASCAL, Dok. nr.26. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	“Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	<p>Ky program studimi ka për qëllim t’ju japë studentëve njohuri bazë teorike dhe praktike në fushën e Mësuesisë për Arsimin Parashkollor³⁶. Këto njohuri merren përmes kombinimit të një sërë lëndësh:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të formimit të përgjithshëm, në fushat: Edukim Qytetar dhe Figurativ për Arsimin Parashkollor, Edukim Artistik, Edukim Fizik; – të formimit karakterizues, në fushat: Zhvillim Matematikor, Zhvillim Gjuhësor, Letërsi për Fëmijë, Arithmetikë, Psikologji Edukimi, Gjuhë Shqipe dhe Didaktikë, Njohuri mbi Historinë, Pedagogji, Shkencat e Natyrës, Reformimi i Sistemit Arsimor dhe Edukativ për Parashkollorët; – të Formimit të Ngjashme ose/dhe Integruese me disiplinat karakterizuese në fushat: Zhvillim Social, Etika; – veprimtari Formuese me Zgjedhje të ofruara nga Institucioni të cilat mund të zgjidhen nga vetë studentët në fushat si Përdorim Kompjuteri, Gjuhë e Huaj I, Gjuhë e Huaj II; – Përmes Praktikave Profesionale.
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Referuar Rregullores së Programit të Studimit ³⁷ “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” synohet aftësimi metodik, pedagogjik dhe edukues i studentit. Ndryshe, misioni i Programit të Studimit synon formimin e aftësive <i>teoriko-shkencore</i> , shprehive praktike, psiko-pedagogjike, gjuhësore, për arritjen e standardeve të larta në mësimdhënie, të cilat do të sigurojnë një përvetësim aktiv të dijeve dhe përmbushin objektivat e arsimit parashkollor në shoqërinë e dijes. Gjithashtu, në Rregulloren e Programit të Studimit, midis objektivave kryesore përmenden shpjegimi i koncepteve themelore në fushën e edukimit parashkollor, reflektimi mbi filozofinë e edukimit tradicional dhe atë të avancuar me “në qendër fëmija”, njohja dhe kuptimi i procesit të edukimit parashkollor, familjar dhe parashkollor të institucionalizuar, si edhe formimi i një filozofie personale të avancuar për edukimin parashkollor. Objektivat e mësipërme arrihen përmes zhvillimit të lëndëve të tilla formuese si Gjuhë dhe Komunikim, Matematikë, Shkenca të Natyrës dhe ato Sociale, Edukim Muzikor dhe Figurativ, Edukim Fizik dhe Shëndetësor, etj.
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara	Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” synon ³⁸ të formojë specialistë në fushën e arsimit parashkollor, duke

³⁶ Ibid

³⁷ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimit “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

³⁸ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimit “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>synuar përgatitjen e edukatorëve me aftësi dhe shprehje profesionale në rritje, që të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të jenë përgjegjës ndaj fëmijëve, të bashkëveprojnë me fëmijët duke demonstruar dashuri dhe respekt; - të inkurajojnë fëmijët të përdorin gjuhën si mjet komunikimi, të krijojnë mundësi për inkurajimin e bashkëveprimit fëmijë-fëmijë; - të inkurajojnë pavarësinë e fëmijës sipas moshës dhe zgjedhjeve të zhvillimit; - të jenë të aftë të nxisin motivimin e brendshëm për t'i ndihmuar fëmijët të njohin botën që i rrethon, të fitojnë njohuri, aftësi dhe vlera; <p>Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e avancuara në fushën e arsimit parashkollor, formohen përmes zhvillimit të lëndëve³⁹ të natyrave të ndryshme, si edhe përmes praktikave profesionale.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Dosja e plotë e Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”⁴⁰, si edhe Rregullorja e Programit të Studimit⁴¹ pasqyrojnë ndryshimet dhe kërkesat ligjore të rrjedhura nga zbatimi i Ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, programi i studimit përfshin në përgjithësi të gjitha elementet që parashikon si të detyrueshme VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, e ndryshuar. Kështu, në dosje përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kreditet, sipa Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS); kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; - objektivat formuese dhe kompetencat profesionale; - veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit; - plani mësimor; - kuotat e pranimit dhe grupet mësimore; - programet lëndore (Syllabus-et); - profili i programit; - diploma dhe suplementi; <p>Në Rregulloren e Programit të Studimit nuk përfshihen vetëm Kodi i Etikës i Programit të Studimit, element ky i detyrueshëm i përcaktuar sipas VKM-së nr. 879, datë 18.12.2019.</p> <p><i>Rekomandohet që Rregullorja e Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” të plotësohet me Kodin e Etikës të Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”.</i></p>

³⁹ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 16.3, “Syllabuset BA-Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ASCAL, Dok. nr.32. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁴⁰ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 13, Dosja e plotë e Programit të Studimit me elementët përbërës të tij”, ASCAL, Dok. nr.26. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁴¹ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimit “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>GVJ mbas shqyrtimit të planit mësimor konstaton se gjenden të gjitha ndarjet sipas veprimtarive formuese nga A-E si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lëndë bazë ose të përgjithshme (43.5 kredite, ose 24.16%); - lëndë karakterizuese (82.5 kredite, ose 45.83%); - lëndë ndërdisiplinore (25.5 kredite, ose 14.16%); - lëndë plotësuese (22.5 kredite, ose 12.5%); - detyrime përmbyllëse (6 kredite, ose 3.33%); <p>Sipas Shtojcës nr.1 (Tabela 1) të VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, shuma e lëndëve bazë plus lëndët karakterizuese duhet të jetë 70%. Konstatohet se ky kusht plotësohet.</p> <p>Programet specifike të çdo lënde⁴² janë bazuar dhe plotësojnë kërkesat e Shtojcës nr.2 të VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesën përshkruese, tipin e lëndës, llojin e lëndës, kreditet, kodin, si edhe adresën elektronike të pedagogut; - Përmbledhjen dhe rezultatin e të nxënit; - Konceptet themelore, temat e lëndës; - Forma e kontrollit të dijeve, frekuentimi; - Kontrolli i vazhdueshëm, literatura; - Vërejtjet përfundimtare nga pedagogu i lëndës; 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor është ngritur sipas Urdhrit nr.408, datë 13.07.2018, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Bazuar në vendimin e Bordit të Akreditimit nr.18, datë 11.05.2018, me vendimin nr.432, datë 20.07.2018, të MASR është urdhëruar <i>Hapja e Programit të Studimit të Ciklit të Parë “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” të Kolegjit Universitar “LOGOS”</i>.</p> <p>Referuar VKM nr.418, datë 10.5.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”, kërkesë kryesore për hapjen e një programi studimi është që <i>njësia bazë duhet të ketë në përbërje të saj, të paktën 7 anëtarë me kohë të</i></p>

⁴² Ibid



	<p><i>plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik.</i></p> <p>Për shkak të numrit të ulët të studentëve, KU "LOGOS" ka marrë miratimin e MASR⁴³ dhe është pranuar që numri minimal i personelit akademik me kohë të plotë për DPP të jetë 5, nga të cilët dy prej tyre të kenë gradë apo titull shkencor dhe se personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë, për çdo rast, jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore.</p> <p>Aktualisht, për vitin akademik 2020-2021, DPP i KU "LOGOS", përgjegjës për zbatimin e Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ka në përbërje të tij 6 (gjashtë) personel efektiv akademik, nga të cilët 4 (katër) janë me tituj/grada shkencore⁴⁴.</p> <p>Theksojmë, që për një mirëfunksionim të Programit të Studimit dhe për të ekuilibruar ngarkesën mësimore, KU "LOGOS" ka angazhuar edhe 9 (nëntë) pedagogë të tjerë, pjesë të personelit PAE, që e zhvillojnë jetën akademike brenda KU "LOGOS"⁴⁵.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Rezulton se pranë DPP të FSHHKGJ pranë KU "LOGOS" nuk ka koordinator të emëruar apo të zgjedhur për Programin e Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor". Deri tani këtë funksion e ka kryer Drejtuesi i Departamentit.</p> <p><i>Rekomandohet plotësimi i Rregullores së FSHHKGJ dhe i Rregullores së DPP lidhur me pozicionin e Koordinatorit të Programit të Studimit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor ka në përbërje tre departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës; 2. Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek; 3. Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë; <p>Në përbërjen e Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë për vitin akademik 2020-2021 janë 6 pedagogë efektivë me kohë të plotë, nga të cilët 4 janë me tituj/grada shkencore. Gjithashtu, në strukturën e departamentit ekziston edhe personeli ndihmës akademik me karakter administrativ, në të cilën bën pjesë sekretaria</p>

⁴³ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 46.2, Marrëveshje MAS, Reduktimi i numrit të personelit akademik në njësinë bazë", ASCAL, Dok. nr.117. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁴⁴ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 18, Tabela 1, Numri i Personelit akademik në njësinë kryesore dhe përgjegjëse", ASCAL, Dok. nr.34. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁴⁵ Kolegji Universitar "Logos", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 18, Tabela 1.3. Numri i personelit akademik në njësinë përgjegjëse", ASCAL, Dok. nr.34. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>mësimore ⁴⁶, e cila mirëmban dhe administron të gjithë dokumentacionin e duhur arsimor, si edhe punonjës të tjerë për shërbime të tjera ndihmëse.</p> <p>Një analizë më e detajuar mbi përbërjen e DPP, bashkë me rekomandimin përkatës, është dhënë në Standardin I.4, Kriteri 1 të këtij Raporti Vlerësues.</p>			
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Programi i Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” mbulohet nga Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë si edhe nga personel të tjerë akademikë efektivë që janë në përbërje të Kolegjit Universitar “LOGOS”. Kështu, janë të angazhuar për vitin akademik 2020-2021, 15 (pesëmbëdhjetë) personel akademik efektiv PAE. Nga këta, 6 (gjashtë) janë PAE në përbërje të DPP si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – 1 anëtar me titullin Profesor – 1 anëtar me titullin Profesor i Asociuar – 2 anëtarë me gradë Dr/PhD – 2 anëtarë janë Master i Shkencave (1 në proces doktorature) <p>Pjesa tjetër e personelit PAE që kryen jetën akademike brenda Kolegjit prej 9 (nëntë) pedagogësh, rezultojnë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – 2 anëtarë me titullin Profesor i Asociuar – 1 anëtar me gradën Doktor i Shkencave – 2 anëtarë në proces doktorature – 4 anëtarë me gradën Master i Shkencave. <p>Nga të dhënat e Tabelës nr.4⁴⁷, rezultojnë se orët totale të zhvilluara nga i gjithë personeli akademik (PAE + PAK) janë 2645 orë mësimore. Nga këto, 2150 orë mësimore (ose 81.2%) janë zhvilluar nga PAE, ndërsa 495 orë (ose 18.8%) janë zhvilluar nga PAK.</p> <p>Kështu, në përfundim rezultojnë se PAE mbulon në masën 81.2% të ngarkesës mësimore të Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, një raport që është përtej kufirit limit prej 70% të përcaktuar nga VKM nr.418, datë 10.5.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi II.3

⁴⁶ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 6, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor”, ASCAL, Dok. nr.18. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁴⁷ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 20, Tabela Nr.4, Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë”, ASCAL, Dok. nr.36. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Referuar dosjes së vetëvlerësimit, vizitës në institucion, GVJ konstaton se informacionet kryesore rreth Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” sigurohen përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Rregullores së FSHHKGJ⁴⁸ – Rregullores së DPP⁴⁹ – Rregullores së Programit të Studimit⁵⁰ – Website-t zyrtar të Kolegjit Universitar “LOGOS” http://www.kulogos.edu.al/al/index.html <p>Në dokumentet e mësipërme rregullatore përfshihen informacione të përgjithshme dhe të hollësishme rreth organizimit në kohë dhe në kredite të Programit të Studimit, mënyrës së pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve, mënyrën e organizimit të studimeve në vite, semestra, lëndë, si edhe praktika profesionale, mënyrës së kontrollit të dijeve, informacione rreth frekuentimit, detyrimit për kryerjen e praktikës profesionale, për dhënien e provimit të formimit apo përgatitjen e temës së diplomës, për pajisjen me diplomë, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar Planit Mësimor të Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”⁵¹, konstatohet se plani mësimor është i organizuar në lëndë dhe aktivitete formuese në përputhje me VKM nr.41, datë 24.01.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Çdo lëndë vlerësohet me kredite, çdo lëndë ka të përcaktuara orët javore, orët në auditor dhe jashtë auditorit.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe konsultuar, GVJ konstaton se programi i studimit është i organizuar në 6 semestra me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike.</p> <p>Referuar programit akademik për vitin 2020-2021⁵² programi siguron ndarje të lëndëve mësimore si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – lëndë bazë ose të përgjithshme (43.5 kredite, ose 24.16%); – lëndë karakterizuese (82.5 kredite, ose 45.83%); – lëndë ndërdisiplinore (25.5 kredite, ose 14.16%);

⁴⁸ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor", ASCAL, Dok. nr.18. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁴⁹ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6.1, Draft-Rregullore e DPP-së ", ASCAL, Dok. nr.19. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁵⁰ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimit “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁵¹ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 13, Dosja e plotë e Programit të Studimit me elementët përbërës të tij", ASCAL, Dok. nr.26. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁵² Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 16.3, “Syllabuset BA-Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ASCAL, Dok. nr.32. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>


	<ul style="list-style-type: none"> - lëndë plotësuese (22.5 kredite, ose 12.5%); - detyrime përmbyllëse (6 kredite, ose 3.33%); <p>Sipas Shtojcës nr.1 (Tabela 1) të VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, shuma e lëndëve bazë plus lëndët karakterizuese duhet të jetë 70% dhe ky kusht plotësohet.</p> <p>Programet specifike të çdo lënde⁵³ janë bazuar dhe plotësojnë kërkesat e Shtojcës nr.2 të VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesën përshkruese, tipin e lëndës, llojin e lëndës, kreditet, kodin, si edhe adresën elektronike të pedagogut; - Përmbledhjen dhe rezultatin e të nxënit; - Konceptet themelore, temat e lëndës. - Formën e kontrollit të dijeve, frekuentimin; - Kontrollin e vazhdueshëm, literature; - Vërejtjet përfundimtare nga pedagogu i lëndës;
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit të studimit bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor, GVJ konstatoi se në planin mësimor të programit janë të pasqyruara informacionet lidhur me ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit. Në rregulloren e programit si dhe në syllabuset e lëndëve, paraqitet informacion i hollësishëm për frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, etj⁵⁴. Plani mësimor përmban kodin e lëndës, emrin e lëndës, kreditet, ngarkesën mësimore në orë brenda dhe jashtë auditorit. Gjatë një viti akademik, sasia e krediteve të përfituara është 60⁵⁵. Gjithsej, orë mësimore gjatë gjithë ciklit 3 vjeçar të studimit janë 4500 ore.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se pranimi i studentëve në KU “LOGOS” bazohet në nenin 74 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, duke u nisur nga kriteri i notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.</p> <p>Në mënyrë më specifike, kriteret për aplikim dhe rregjistrim për Programin e Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, jepen në nenin 5 të Rregullores së Programit të Studimit⁵⁶, sipas të cilit, për t’u pranuar në programin universitar</p>

⁵³ Ibid

⁵⁴ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 13, Dosja e plotë e Programit të Studimit me elementët përbërës të tij", ASCAL, Dok. nr.26. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁵⁵ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimit “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁵⁶ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimit “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



	<p>të studimit të ciklit të parë “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, kandidati duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të ketë përfunduar me sukses arsimin e mesëm dhe zotërojë një diplomë të shoqëruar me listën e notave; - Të plotësojë kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me VKM; - Të plotësojë kriteret e përcaktuara nga departamenti; <p>Ndërsa në nenin 15 të Rregullores së programit të studimit, sanksionohet e drejta e studentit për transferim, nga apo për në KU “LOGOS”. Për këtë proces, Dekanati i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor që mbulon programin e studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, në përputhje të plotë me statutin e Kolegjit Universitar “LOGOS” dhe vendimin e komisionit ad-hoc të ngritur, vendos për vazhdimin ose jo të studimeve të mëtejshme me qëllim përfundimin e ciklit të parë në këtë institucion.</p> <p>Procedura e hollësishme që ndiqet për transferim, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm për transferim, gjendet në Rregulloren e Përgjithshme të Kolegjit Universitar “LOGOS”⁵⁷, në nenet 80, 85-88, si edhe në Rregulloren e Posaçme të Transferimeve⁵⁸.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Referuar DVV, syllabuseve të lëndëve, rezulton se ato janë në përputhje me ⁵⁹, VKM nr.41, datë 24.01.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, dhe ofrojnë informacionin e nevojshëm për studentët. GVJ konstaton se Syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve, ngarkesën javore si dhe detyrimet lëndore.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik</p>	<p>Planet mësimore lëndore të Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” janë rishikuar për të tre vitet akademike 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021 ⁶⁰. Gjithashtu, procedurat e ndjekura për ndryshimin e kurrikulës⁶¹ pasqyrojnë të</p>

⁵⁷ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 5, Rregullore e Përgjithshme e KU “LOGOS”, ASCAL, Dok. nr.17. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁵⁸ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 50, Rregullore e Transferimeve", ASCAL, Dok. nr.138. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>


⁵⁹ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 16.3, “Syllabuset BA-Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ASCAL, Dok. nr.32. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁶⁰ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 16.1, Syllabuset e lëndëve 2018-2019", ASCAL, Dok. nr.30. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 16.2, “Syllabuset e lëndëve 2019-2020”, ASCAL, Dok. nr.31. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 16.3, “Syllabuset BA-Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ASCAL, Dok. nr.32. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁶¹ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 44, Procedurat për Ndryshimin e Kurrikulës", ASCAL, Dok. nr.111. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	gjitha hapat e ndjekur institucionalë nga organet drejtuese të DPP, FSHHKGJ, si edhe të KU "LOGOS" për realizimin e këtyre ndryshimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>GVJ konstaton se plani mësimor i Programit të Studimit është i organizuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - sipas përcaktimeve të VKM nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; - sipas Rregullores së Programit të Studimit⁶²; - sipas Kalendarit Akademik të Kolegjit Universitar "LOGOS"; Referuar Rregullores së Programit të Studimit, parashikohet që: - Plani mësimor është shpërndarë për 3 vite akademike me nga 60 ECTS për secilin vit akademik, që i korrespondon 1.500 orë/vit akademik; - Fillimi dhe përfundimi i vitit akademik përcaktohet me vendim të MASR; - 1 krediti i korrespondon 25 orë mësimore, nga të cilat 13-15 orë janë orë individuale të studentit; - Viti akademik ka 30 javë mësimore; - Viti akademik parashikon 3 sezona provimesh; - Studenti ka detyrimin të ndjekë për çdo lëndë në masën 75% të aktivitetit mësimor të zhvilluar në auditor (leksione, seminare, detyrë kursi,);
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	<p>Referuar RVB-së, shpërndarja e orëve të lëndëve dhe të praktikave mësimore në leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila disiplinë. Shpërndarja përgjithësisht është bazuar sipas përcaktimeve të VKM nr.41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar". Raporti i orëve leksione/seminare, bazohet në</p>

⁶² Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimit "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



	<p>natyrën e lëndës (nëse lëndët janë me natyrë teorike apo praktike), ndërsa sa i përket zhvillimit të lëndëve me zgjedhje, ato koordinohen në varësi të numrit të studentëve që i ndjekin.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Ashtu siç është përmendur edhe më sipër në këtë RVJ, Programi akademik i Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” për vitin 2020-2021⁶³ siguron ndarje të lëndëve mësimore si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – lëndë bazë ose të përgjithshme (43.5 kredite, ose 24.16%); – lëndë karakterizuese (82.5 kredite, ose 45.83%); – lëndë ndërdisiplinore (25.5 kredite, ose 14.16%); – lëndë plotësuese (22.5 kredite, ose 12.5%); – detyrime përmbyllëse (6 kredite, ose 3.33%); <p>Gjithashtu, kjo lloj ndarje plotëson kushtin e vendosur në Shtojcën nr.1 (Tabela 1) të VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, sipas të cilës shuma e lëndëve bazë plus lëndët karakterizuese duhet të jetë 70%.</p> <p>Siç edhe arsyetohet në RVB, shpërndarja e lëndëve në semestra dhe vite ndjek parimin e kalimit gradual të studentëve nga koncepte themelore në koncepte dhe aplikime të avancuara të praktikës profesionale dhe të kërkimit shkencor, duke kaluar nga lëndët bazë-hyrëse, si Hyrja në Psikologji (Semestri I), në lëndë më të avancuara, si Psikologji Zhvillimi (Semestri II), Psikologji Edukimi (Semestri III), Edukim Special (Semestri IV), Pedagogji Familjare (Semestri V) dhe Vlerësimi i Fëmijëve. Një shpërndarje e tillë u mundëson studentëve që të përvetësojnë në mënyrë organike objektivat formuese të programit të studimit, duke i kthyer ato në rezultate të të nxënit.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Institucionit, rezulton se struktura e Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, organizimi i lëndëve dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, dhe raporti teori/praktikë është në përputhje me VKM nr. 41 datë 24.01.2018. Nga takimet me stafin akademik, rezulton se stafi akademik bën përpjekje të konsiderueshme për të përditësuar syllabus-et me ato të zhvilluara në programe studimi të ngjashme ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është i organizuar në lëndë, module, praktika e aktivitete formuese, duke bërë të mundur arritjen e rezultateve të të nxënit, me qëllim përgatitjen e studentëve për t’u punësuar sipas profilit të programit. Nëse shikohet struktura e syllabuseve lëndore, vihet re se me kalimin nga viti në vit, kalohet nga aspektet teorike,</p>

⁶³ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 16.3, “Syllabuset BA-Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ASCAL, Dok. nr.32. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



	<p>në aspekte teorike-praktike dhe në fund drejt praktikës dhe aftësimit profesional të studentëve. Mund të thuhet se syllabuset e lëndëve janë ndërtuar në një mënyrë të tillë që mundësojnë transferimin apo mobilitetin i studentëve sipas një procesi të arsyeshëm dhe jotraumatik.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" është program i hapur rishtas dhe gjatë periudhës 2018-2021 ka përjetur dy gjendje të jashtëzakonshme: atë të termetit dhe atë të pandemisë. Megjithatë, ashtu siç pranohet edhe në RVB, si edhe nga dokumentacioni i dorëzuar nga Institucioni, konstatohet që ka një mungesë të pjesshme të përditësimit të programeve lëndëve/moduleve me literaturë të detyruar dhe ndihmëse të përditësuar të 5 viteve të fundit.</p> <p><i>Rokomandohet përditësimi i literaturës së detyruar, i programeve të lëndëve/moduleve të programit të studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", me literaturë të 5 viteve të fundit.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", sipas Rregullores së Programit të Studimit⁶⁴, parashikon se në përfundim të përmbushjes me sukses të Programit të Studimit, studentët fitojnë këto kompetenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; - Kompetenca e të menduarit; - Kompetenca e të mësuarit; - Kompetenca për jetën; - Kompetenca personale; - Kompetenca qytetare; - Kompetenca digjitale; <p>Këto kompetenca garantohehen përmes zhvillimit dhe përvehtësimit të lëndëve të tilla si Psikologji Edukimi, Gjuhë dhe Komunikim, Edukim Qytetar, Etikë, Didaktikë, Përdorim Kompjuteri, etj.</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", i ofruar nga KU "LOGOS", i korrespondon nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Sipas Shtojcës 1 të KSHK, përfundimi me sukses i këtij programi u mundëson studentëve vijimin e mëtejshëm të studimeve në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Master i Shkencave; - Master Profesional; <p>Ose, në mënyrë alternative, përfundimi me sukses i Programit të Studimit mundëson punësimin drejt profesionit të mësuesisë në arsimin parashkollor.</p>

⁶⁴ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 13, Dosja e plotë e Programit të Studimit me elementët përbërës të tij", ASCAL, Dok. nr.26. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Referuar RVB, si edhe nga bisedat dhe intervistat me pedagogët, studentët, si edhe me titullarët e institucionit, përmendet fakti se janë realizuar disa workshop-e dhe veprimtari në bashkëpunim me partnerët nga tregu i punës, të cilat kanë shërbyer si dritare komunikimi dhe ofertash për njohjen e studentëve me mundësitë që kanë për t'u përshtatur me tregun e punës.</p> <p>Ndërsa në Aneksin 27⁶⁵ "Marrëveshjet e bashkëpunimit" tregohet numri i marrëveshjeve bashkëpunuese, afati i tyre, si edhe tematika e këtyre marrëveshjeve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.5</p>	
<p>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar dokumentit (<i>Aneks 19. Tabela 2. Te dhenat per personelin akademik ne programin e studimit</i>), të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike janë si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021 janë të angazhuar 23 pedagogë ndër të cilët 15 PAE dhe 8 PAK;</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Mbulimi i programit në përqindje është 65% PAE dhe 35% PAK.</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 janë të angazhuar 18 pedagogë ndër të cilët 10 PAE dhe 8 PAK.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është 55% PAE dhe 45% PAK.</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019 janë të angazhuar 14 pedagogë ndër të cilët 7 PAE dhe 7 PAK.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është 50% PAE dhe 50% PAK.</p> <p>Për sa i përket kualifikimeve të Personelit Akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për 2020-2021, 56% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 44% janë Msc; - Për 2019-2020, 67% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 37% janë Msc;

⁶⁵ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 27, Marrëveshjet e bashkëpunimit", ASCAL, Dok. nr.43. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



	<p>- Për 2018-2019, 57% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 43% janë Msc;</p> <p>Siç është përmendur më sipër në këtë RVJ, për shkak të numrit të vogël të studentëve të pranuar në programin e studimit, është marrë miratim nga MASR për ngritjen e Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë me 5 personel akademik efektiv. Aktualisht DPP ka në përbërjen e tij 6 personal akademik PAE.⁶⁶</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Rezulton se personeli akademik që mbulon zhvillimin e Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" ka nivel arsimimi dhe kualifikimi të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm për realizimin cilësor të këtij programi. CV-të e personelit akademik⁶⁷ (PAE dhe PAK) të tregojnë se formimi i tyre bazë universitar, arsimimi i mëtejshëm plotësues, kualifikimet e mëtejshme të tyre, si edhe trajnimet e vazhdueshme brenda dhe jashtë vendit, janë në përputhje me llojin dhe nivelin e programit të studimit. Gjithashtu, rezulton se çdo personel akademik, si PAE ashtu edhe PAK, mbulon ato lëndë/module/praktika profesionale që janë në përputhje me kualifikimin e tyre vetjak akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Ashtu siç përmendet edhe në RVB, praktika profesionale në Programin e Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" zhvillohet në semestrin e parë të vitit të dytë dhe në semestrin e parë të vitit të tretë. Gjithashtu, menjëherë pas saj në të dy vitet zhvillohen praktikimet në arte dhe administrim, të cilat ndihmojnë në formimin e aftësive praktike të studentëve. Rezulton se ka patur kufizime për zhvillimin e këtyre praktikave gjatë periudhës 2019-2021, për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme të shkaktuar nga tërmeti i vitit 2019 dhe pandemia për shkak të Covid-19.</p> <p>Përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës Gjithashtu, KU "LOGOS" ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit, për kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale të studentëve të Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë⁶⁸. Rrethi i aktorëve me të cilat Kolegji Universitar "LOGOS" ka marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e ndërsjelltë të praktikave profesionale, përfshin Institucione të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, çerdhe dhe kopshte të qyteteve të ndryshme, shoqata dhe fondacione të ndryshme, si edhe shkolla të niveleve të ndryshme publike dhe private.</p>

⁶⁶ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 17, CV e stafit akademik", ASCAL, Dok. nr.33.

Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁶⁷ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 17, CV e stafit akademik", ASCAL, Dok. nr.33.

Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁶⁸ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 26, Tabela Nr.5, Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë", ASCAL, Dok. nr.42. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>


	Gjatë gjithë periudhës së kryerjes së praktikave profesionale, studentët janë nën monitorimin e vazhdueshëm të pedagogut të caktuar posaçërisht për këtë qëllim. Në vitin e tretë parashikohet edhe punimi i temës së diplomës. Punimi i diplomës “Bachelor” është në formën e një projekti apo përmbledhje punimesh të kryera në fushat e programit përkatës të studimit dhe përmban çështje, mënyra e shtrimit të të cilave i jep mundësi studentit që, nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit, të tregojë aftësitë e tij për të zgjidhur elementë të veçantë të detyrave projektuese, probleme të prodhimit, praktikës laboratorike apo për të punuar me literaturën në fushën përkatëse. Gjatë gjithë periudhës së temës së diplomës, student udhëhiqet nga pedagogu i caktuar për këtë qëllim.			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Rezulton se, siç është përmendur edhe në RVB, zhvillimi i syllabuseve të lëndëve që zhvillohen në këtë programi studimi, parashikon edhe orë laboratorike në mësimin e lëndëve <i>Përdorim Kompjuteri, Shkencat e Natyrës, Praktikum për Artet</i> , si edhe <i>Metodika e Shkencave të Natyrës</i> . Rezulton se, për shkak të numrit të ulët të studentëve, nuk ka personel ndihmës mësimor për këto orë laboratorike dhe praktikisht orët laboratorike realizohen nga vetë pedagogët e lëndëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Nisur edhe nga situata e jashtëzakonshme e shkaktuar nga pandemia për shkak të Covid-19, Kolegji Universitar “LOGOS” ka miratuar gjatë vitit 2020-2021 disa udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, të tillë si: <ul style="list-style-type: none"> – Udhëzues për mësimdhënien dhe mësimin në distancë, i ndarë për stafin akademik dhe për studentët⁶⁹.

⁶⁹ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 38, Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit", ASCAL, Dok. nr.98. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhër për përdorimin e platformës digjitale⁷⁰. - Udhëzim për politikën e vlerësimit në distancë⁷¹. <p>Përdorimi me sukses i këtyre metodave inovative, ka mundësuar vijimin e mësimdhënies, si edhe vlerësimin e studentëve pas përfundimit të mësimdhënies online.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Në Kreun VII (neni 43) i Statutit të Kolegjit Universitar “LOGOS”, theksohet se <i>Kolegji Universitar “LOGOS” është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe për kryerjen e kësaj detyre, Kolegji Universitar “LOGOS” ngrre një strukturë më vehte në rang institucioni, që thirret Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC).</i></p> <p>Në vijim të kësaj, Kolegji ka miratuar edhe Rregulloren e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, sipas të cilës rregullohet gjithë veprimtaria institucionale, në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>E drejta e çdo studenti për t’u ankuar ndaj rezultatit përfundimtar të provimit, parashikohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregulloren e Kolegjit Universitar “LOGOS”⁷² (nenet 116, 118, 122). - Rregulloren e Programit të Studimit⁷³ (neni 14). - Rregulloren e DPP-së⁷⁴ (neni 39). <p>Në këto nene saktësohet e gjithë procedura që duhet të ndiqet prej ankimit deri në dhënien përfundimtare të përgjigjes.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Me qëllim sigurimin e cilësisë së mësimdhënies, nga DPP në fund të çdo viti akademik, përmes një pyetësoi të posaçëm⁷⁵, merret mendimi i studentëve lidhur me cilësinë e mësimdhënies, si edhe vlerësimi i studentëve për pedagogët e lëndës. Rezultatet e vlerësimit individual të pedagogëve shqyrtohen edhe nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, i cili i ofron rekomandimet e tij departamenteve përkatëse. Raporti i Analizës së Pyetësorëve të studentëve është bërë për vitet akademike 2018- 2019 dhe 2019-2020⁷⁶ dhe është i detajuar për çdo njësi kryesore dhe për</p>

⁷⁰ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 46.5, Rektorati- Urdhër- Platforma digjitale", ASCAL, Dok. nr.120. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷¹ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 46.6, SA- Udhëzim për politikën e vlerësimit në distancë", ASCAL, Dok. nr.121. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷² Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 5, Rregullore e Përgjithshme e KU “LOGOS”, ASCAL, Dok. nr.17. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷³ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimit “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷⁴ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor", ASCAL, Dok. nr.18. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷⁵ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 32, Pyetësor i studentëve", ASCAL, Dok. nr.64. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷⁶ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.5, NJSBS_ Rezultatet e pyetësorëve", ASCAL, Dok. nr.131. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>
 Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.6, Vlerësimi i performancës së stafit, pyetësor, Sem I, 2019-2020", ASCAL, Dok. nr.132. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>çdo program studimi. Raporti paraqet nivelin e pjesëmarrjes së studentëve në pyetësor, analizën e të dhënave, si edhe komentet e studentëve.</p> <p>Rekomandohet që raporti i analizës së pyetësorëve të botohet edhe në faqen zyrtare të Kolegjit Universitar "LOGOS", ku mund të aksesohet me lehtësi si nga studentët, ashtu edhe nga çdo person tjetër i interesuar.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Të dhënat e marra nga raportet vjetore të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies prej studentëve, kanë shërbyer si një burim i rëndësishëm informacioni për rritjen e cilësisë së veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore⁷⁷. Një shembull i praktikave të mira që ndjek institucioni, është edhe rimbursimi i shpenzimeve për kërkimin shkencor apo për pjesëmarrje në konferenca shkencore apo publikime në revista shkencore, brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, shumë pedagogë të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor kanë marrë pjesë në kuadër të Programit Erasmus+ apo në projekte të tjera kërkimore-shkencore.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Referuar Rregullores së DPP-së⁷⁸ në nenin 29 theksohen se format e mësimdhënies janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - leksionet - seminarët - praktikat profesionale - detyrat e kursit - provimet - mbrojtja e diplomës <p>Ndërsa në nenin 15 të kësaj rregulloreje jepet një pasqyrë më e detajuar e formave të mësimdhënies dhe konkretisht theksohet se</p>

Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.7, Raport nga NJSBC për rezultatet 22.07.2019", ASCAL, Dok. nr.133. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷⁷ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.3, Raporti Vjetor 2018-2019, Kolegji Universitar LOGOS", ASCAL, Dok. nr.47. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.4, Raporti Vjetor 2019-2020, Kolegji Universitar LOGOS", ASCAL, Dok. nr.48. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 30, Raporte Vjetore të monitorimit dhe Sigurimit të Cilësisë", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷⁸ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6.1, Draft-Rregullore e DPP-së ", ASCAL, Dok. nr.19. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	veprimtaritë formuese realizohen nëpërmjet <i>mësimit në auditor</i> (leksione, seminare, ushtrime, laboratore), <i>studimit individual</i> (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje e punimit të diplomës/provim formimi) dhe <i>praktikës profesionale</i> .
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Siç është përmendur edhe më sipër në këtë RVJ, programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" në KU "LOGOS" ka filluar për herë të parë në vitin akademik 2018-2019 dhe gjatë zhvillimit të tij është përballuar me ato kufizime që kanë prekur edhe gjithë sistemin arsimor, për shkak të tërmetit të vitit 2019 apo pandemisë prej Covid 2019. Në këto kushte, gjatë periudhës së kufizimeve është përdorur më së shumti mësimi online si një mënyrë alternative studimi, i kombinuar me forma të tjera në ato raste kur ka qënë e mundur.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Nisur nga kushtet e veçanta të njohura të periudhës 2019-2021, KU "LOGOS" ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Në këto udhëzues, përfshihet një dokumentacion i plotë për mësimet online dhe vlerësimin e studentëve. Nga intervistat me drejtues, personel akademik efektiv, si edhe me përfaqësues të studentëve, rezultojnë se këto metoda zotërohen dhe përdoren në mënyrë efektive nga personeli akademik.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Bazuar në jetëshkrimet e personelit akademik efektiv ⁷⁹ si edhe të atij me kontratë, rezultojnë se stafi akademike në përgjithësi i përmbush kriteret ligjore dhe akademike të kualifikimit profesional. Anëtarët e stafit vijnë nga backgrounde të ndryshme arsimore, janë një kombinim i mirë brezash, si edhe një pjesë e tyre janë me formim tërësisht perëndimor. Gjithashtu, nga intervistat me drejtues dhe personel akademik efektiv, si edhe me përfaqësues të studentëve, rezultojnë se të gjitha metodat e mësimdhënies, të parashikuara në Udhëzuesin për përdorimin e platformave digjitale <i>Edupage</i> dhe <i>Microsoft Teams 365</i> , zotërohen nga personeli akademik dhe zbatohen në praktikë.
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë	Rezultojnë se në përfundim të dy viteve akademike 2018-2019 dhe 2019-2020 janë realizuar intervista të strukturuar përmes pyetësorëve të posaçëm ⁸⁰ , përmes të cilave është marrë mendimi i

⁷⁹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 17, CV e stafit akademik", ASCAL, Dok. nr.33. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁸⁰ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.5, NJSBS_Rezultatet e pyetësorëve", ASCAL, Dok. nr.131. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>
Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.6, Vlerësimi i performancës së stafit, pyetësor, Sem I, 2019-2020", ASCAL, Dok. nr.132. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>
Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.7, Raport nga NJSBC për rezultatet 22.07.2019", ASCAL, Dok. nr.133. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	studentëve mbi format dhe metodat e mësimdhënies, nivelin e shpjegimit prej pedagogëve të koncepteve të reja, shkallën e komunikimit me studentët, shkallën e vlerësimit të dijeve të marra, nivelin e motivimit të pedagogëve, etj. Nga përfundimet e marra nga këta pyetësorë, rezultoi se në përgjithësi studentët janë të kënaqur me nivelin e mësimdhënies, si edhe me metodat e mësimdhënies të përdorura.			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	Sipas bisedave me përfaqësues të studentëve, rezultoi se në orët mësimore të zhvilluara në kuadër të Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ashtu siç e parashikon edhe Rregullorja e FSHHKGJ dhe Rregullorja e DPP, praktikohen forma të ndryshme të mësimdhënies interaktive si leksione (formale, të pikëtuara, provokative, etj.), demonstrime, lojra, raste studimore, si edhe projekte të llojeve të ndryshme.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Në nenin 42 të Rregullores së DPP ⁸¹ , lidhur me punimin e temës së diplomës, theksohet se studenti ka të drejtë të shprehë dëshirën e tij në lidhje me punimin e diplomës që kërkon të zhvillojë dhe udhëheqësin e tij. Ai mund të propozojë edhe vetë një punim tjetër diplome së bashku me udhëheqësin përkatës. Udhëheqësi i punimit të diplomës, në bashkëpunim me studentin, përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardeve	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të	Procesi mësimor i Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" të KU "LOGOS" zhvillohet në ambientet e Kampusit nr.1 në qytetin e Tiranës. Nga vëzhgimet fizike pranë këtij kampusi, si edhe nga të dhënat e paraqitura në këtë RVB ⁸² , rezultoi se

⁸¹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6.1, Draft-Rregullore e DPP-së", ASCAL, Dok. nr.19. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁸² Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 34.1, Infrastruktura, DPP", ASCAL, Dok. nr.66.

Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 34.2, Infrastruktura FSHHKGJ", ASCAL, Dok. nr.67.

Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 34.4, Inspektim Teknik Kampus", ASCAL, Dok.

nr.69. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 34.8, Relacion mbi Infrastrukturën 2020", ASCAL, Dok. nr.73. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>DPP disponon një infrastrukturë më se të mjaftueshme fizike, materiale dhe teknike. Në dispozicion të DPP janë 3 auditorë me sipërfaqe rreth 40m² secili, me ndriçim dhe me ajrosje natyrale dhe artificiale. Norma e sipërfaqes së shfrytëzueshme është 18m²/për student.</p> <p>Në dispozicion të DPP-së janë edhe laboratorët në dispozicion të programit të studimit me sipërfaqe 27 m² (14 poste pune) dhe 63 m² (18 poste pune), me ndriçim dhe kondicionim. Biblioteka në kampusin kryesor në Tiranë zë një sipërfaqe 186 m² dhe ka 18 poste me akses kompjuteri dhe 40 poste të tjera studimi. Gjithashtu, në dispozicion të DPP-së për programin e studimit janë edhe 3 nyje sanitare me nga dy tualete secila, të ndara respektivisht për meshkuj dhe femra, një palestër me pajisje të teknologjisë së fundit dhe hapësirë të mjaftueshme, me dhomë zhveshje, tualete dhe dushe, një sallë konferencash me një sipërfaqe 245 m² e pajisur me teknologji moderne, ekrane, fonë dhe njësi përkthimi dhe me një kapacitet prej 185 vendesh, një mjedis rekreacioni me sipërfaqe 213 m² në dispozicion të studentëve për të diskutuar dhe konsumuar ushqim, një mjedis infermierik në mbështetje të shëndetit të studentëve dhe stafit akademik. Rezulton, gjithashtu, se të gjitha mjediset universitare janë të pajisura me lejet përkatëse shtetërore të plotësimit të standarteve sanitare dhe të mbrojtjes nga zjarri.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Pas vëzhgimit në terren, ashtu si u përmend në kriterin 1 të mësipërm, rezultoi se mbështetja logjistike në funksion të zbatimit të Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" është më se e plotë dhe e mjaftueshme për realizimin me sukses të procesit mësimor, duke filluar nga tavolinat e punës, dërrasa shpjeguese, projektorë, njësi kompjuterike, si edhe me çdo element tjetër të nevojshëm për zhvillimin me sukses të procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Në funksion të zhvillimit të Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" është një sallë interneti me sipërfaqe 90m² ndërsa në të gjithë godinën e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor sigurohet lidhje e përhershme internet me rrjet fikse dhe WiFi.</p> <p>KU "LOGOS" disponon edhe faqen zyrtare http://www.kulogos.edu.al/al/index.html e cila shërben njëkohësisht edhe si platformë interaktive. Në përbërje të këtij portali, janë edhe Platformat Edupage.al dhe Microsoft Office 365.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton</p>	<p>Literatura⁸³ e përditësuar deri në vitin 2021 për Programin e Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" përfshin literaturën bazë dhe atë ndihmëse dhe u bëhet e njohur studentëve prej fillimit të vitit të ri akademik. Kjo literaturë miratohet nga departamenti, me</p>

⁸³ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 57.6, Lista e titujve për arsimin parashkollor 2018-Maj 2021 në Bibliotekën LOGOS", ASCAL, Dok. nr.179. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	propozim të titullarëve të lëndëve. Në mënyrë më specifike, literatura bazë dhe ndihmëse përcaktohet në çdo program lëndor ⁸⁴ (syllabus) dhe ofrohet në gjuhën shqipe (por edhe në gjuhë të huaj), si edhe përditësohet vazhdimisht prej titullarit të lëndës.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Në funksion të zhvillimit të Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" është edhe Biblioteka e Institucionit, e vendosur në një mjedis prej 186m ² në Kampusin nr.1 të kolegjit dhe me kushte shfrytëzimi më se komode. Biblioteka siguron një numër të mjaftueshëm titujsh ⁸⁵ në format të shkruar dhe atë elektronik (format Cd, DVD, Audio, Video). Biblioteka funksionon përgjatë gjithë vitit (përfshirë bën muaji Gusht) dhe veprimtaria e saj rregullohet përmes Rregullores ⁸⁶ së saj.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Në faqen zyrtare të KU "LOGOS" ⁸⁷ mundësohet edhe akses online për në Bibliotekën e Kolegjit. Biblioteka e Kolegjit Universitar "LOGOS" grumbullon dhe përpunon çdo titull të nevojshëm akademik dhe u shërben studentëve, personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të këtij institucioni dhe përdoruesve të tjerë të anëtarësuar në këtë bibliotekë, në përshtatje me kërkesat arsimore, shkencore dhe kulturore të tyre si dhe në ndihmë të procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe veprimtarive të tjera për të cilat është i angazhuar Kolegji Universitar "LOGOS". Koleksioni i bibliotekës pasurohet vazhdimisht në sajë të blerjeve, abonimeve, shkëmbimeve dhe dhuratave. Titujt zgjidhen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e bëra nga stafi akademik, administrativ dhe studentët. Aktualisht Biblioteka e KU "LOGOS" numëron mbi 23.000 njësi që i përkasin disiplinave të ndryshme. Fondi i bibliotekës është një "fond i hapur" gjë që i jep mundësinë përdoruesit të përzgjedhë vetë materialin që kërkon, bazuar në kërkimin që bëhet në katalogun elektronik. Gjithashtu, Kolegji Universitar "LOGOS" ofron akses në literaturën online të bibliotekës ndërkombëtare Questia Online Library: www.questia.com dhe në bashkëpunim me Universitetin e Pireut, ofron akses në literaturën online të bibliotekës të këtij universiteti. https://www.lib.unipi.gr/en .
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike	DPP disponon në funksion të realizimit të Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" dy laboratorë ⁸⁸ me sipërfaqe 27 m ² (14 poste pune) dhe 63 m ² (18 poste pune) me ndriçim dhe kondicionim më se të mjaftueshëm. Për shkak të situatës së krijuar

⁸⁴ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 16.1, Syllabuset e lëndëve 2018-2019", ASCAL, Dok. nr.30. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁸⁵ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 37, Lista e teksteve dhe periodikëve në Bibliotekë", ASCAL, Dok. nr.96. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁸⁶ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 57.2, Rregullore e miratuar e Bibliotekës 13.02.2019", ASCAL, Dok. nr.175. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁸⁷ <http://ëëë.kulogos.edu.al/al/books.html>

⁸⁸ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 34.1, Infrastruktura, DPP", ASCAL, Dok. nr.66. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	në periudhën 2019-2021, funksionimi i këtyre mjediseve ka funksionuar në përputhje me zbatimin rigoroz të protokolleve sanitare antiCovid. Nga takimi me personelin akademik si edhe me përfaqësues të studentëve, rezulton se në kushte normale të jetës universitare, infrastruktura laboratorike shfrytëzohet mjaftueshëm prej studentëve, në varësi të zbatimit të planit mësimor.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Në funksion të mësimdhënies, KU "LOGOS" në faqen e tij zyrtare http://kulogos.edu.al/al/student-portal.html në seksionin Portali i Studentit, ka të përfshirë edhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit ku përfshihen lajmërimet, evente, orari mësimor, komunikime me stafin pedagogjik, vendime dhe rregullore të miratuara nga organet drejtuese të Kolegjit dhe materiale të tjera të kësaj natyre. Gjithashtu, në këtë portal përfshihen edhe dy platformat Edupage.al dhe Microsoft Office 365. Instruksionet ndihmëse ⁸⁹ mundësojnë familjarizimin dhe përdorimin prej studentëve të këtyre platformave, në funksion të zhvillimit të procesit mësimor.
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Në platformat Edupage.al dhe Microsoft Office 365 si personeli akademik, ashtu edhe çdo student, mund të ngarkojnë materiale mësimore (leksione, detyra të ndryshme, prezantime, etj) që mund të aksesohen në çdo kohë nga të gjithë studentët, apo përmes llogarive të veçanta të studentëve. Gjithashtu, çdo personel akademik ka në dispozicion në këto dy platforma hapësirën e vet individuale, në të cilën mund të ngarkojë leksionet e lëndës/modulit, syllabusin, si edhe mënyrën e administrimit të lëndës përgjatë gjithë semestrit. Për të ndihmuar studentët që të jenë familjarë me këto platforma, kolegji ofron edhe ndihmën e nevojshme ⁹⁰ .
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Bazuar në Rregulloren e FSHHKGJ ⁹¹ , të drejtën për punuar temën e diplomës e kanë vetëm studentët me notë mesatare mbi 7.5. Gjithashtu, siç është përmendur edhe më përpara në këtë RVJ, në nenin 42 të Rregullores së DPP ⁹² , lidhur me punimin e temës së diplomës, theksohet se studenti ka të drejtë të shprehë dëshirën e tij në lidhje me punimin e diplomës që kërkon të zhvillojë dhe udhëheqësin e tij. Ai mund të propozojë edhe vetë një punim tjetër diplome së bashku me udhëheqësin përkatës. Udhëheqësi i punimit të diplomës, në

⁸⁹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 38, Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit", ASCAL, Dok. nr.98. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁹⁰ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 38.1, Shembuj nga EduPage-studentët", ASCAL, Dok. nr.98. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 38.2, Shembuj nga EduPage-Stafi", ASCAL, Dok. nr.99. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 38.3, Akses në EduPage IV.5.3", ASCAL, Dok. nr.100. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁹¹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor", ASCAL, Dok. nr.18. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁹² Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6.1, Draft-Rregullore e DPP-së", ASCAL, Dok. nr.19. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	bashkëpunim me studentin, përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Në KU "LOGOS" është ngritur dhe është funksionale Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ⁹³ (NJSBC). NJSBC e zhvillon veprimtarinë e saj bazuar në Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë ⁹⁴ e cila ka si fushë veprimi sigurimin e cilësisë dhe i referohet një procesi të vazhdueshëm monitorimi, vlerësimi, garantimi dhe përmirësimi të cilësisë të programeve që ofrohen në kolegji, bazuar në kritere të brendshme dhe të jashtme. Rregullorja i shtrin efektet mbi të gjitha aspektet e zhvillimit të veprimtarisë së KU "LOGOS", dhe mbi të gjithë aktorët që kanë përgjegjësi për sigurimin e cilësisë: organet drejtuese, strukturat akademike, ndihmësakademike, njësitë kryesore dhe njësitë bazë, personelin akademik, ndihmësakademik, personelin administrativ, si edhe studentët.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Për Programin e Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", përgjegjëse për sigurimin e cilësisë është Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë, në përbërje të FSHHKGJ. Misioni dhe objektivat e DPP për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies saktësohen në Rregulloren e DPP ⁹⁵ . Sipas rregullores (në nenet 4 dhe 5 të saj) theksohet se: Misioni i DPP, si njësi bazë e FSHHKGJ, bazuar edhe në Statutin e KU "LOGOS", është të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve. Misioni lidhet gjithashtu me: <ul style="list-style-type: none"> - garantimin e cilësisë dhe plotësimin e standardeve akademike për programet e studimit; - nxitjen, mbështetjen dhe zhvillimin e aktivitetit shkencor të pedagogëve dhe studentëve:

⁹³ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.4, Vendime mbi përbërjen e NJSBC-së (2011-2018-2020 të KU-LOGOS)", ASCAL, Dok. nr.130. Parë në Gusht 2021, gjendet

⁹⁴ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 8, Rregullore për Sigurimin e Cilësisë", ASCAL, Dok. nr.21. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁹⁵ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6.1, Draft-Rregullore e DPP-së", ASCAL, Dok. nr.19. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<ul style="list-style-type: none"> - nxitjen dhe koordinimin e aktiviteteve mësimore-kërkimore, pa cënuar lirinë akademike të personelit akademik, përkundrazi, duke stimuluar ndërveprimin ndërdepartamental; - zhvillimin e aktiviteteve kërkimore, konsultave dhe projekteve, bashkëpunimin me departamente të tjera në KU "LOGOS", me institucione të tjera në Shqipëri, me departamente të tjera të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri, me departamente të tjera që janë pjesë e universiteteve të huaja; - formulimin e planit vjetor të zhvillimit të projekteve kërkimore dhe të kompetencave didaktike; <p>Në fund të çdo viti akademik, hartohet dhe punohet raporti vjetor i veprimtarisë së DPP⁹⁶, ku vlerësohet veprimtaria e zhvilluar gjatë vitit dhe konkretizohen plane konkrete për të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitet përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Nga intervistat me pedagogët, si edhe me studentët, u konstatua se në situatën e pandemisë në vitin 2020-2021, në dispozicion të të gjithë stafit akademik janë shpërndarë manuale të mësimit online, si edhe janë zhvilluar trajnime të stafit lidhur me metodat e reja të mësimdhënies.</p> <p>Siç është theksuar edhe më sipër në këtë RVJ, në funksion të mësimdhënies, KU "LOGOS" në faqen e tij zyrtare http://kulogos.edu.al/al/student-portal.html në seksionin Portali i Studentit, përfshihen edhe dy platformat Edupage.al dhe Microsoft Office 365. Instruksionet ndihmëse⁹⁷ mundësojnë familjarizimin dhe përdorimin prej studentëve të këtyre platformave, në funksion të zhvillimit të procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Pranë KU "LOGOS" është ngritur dhe funksionon Qendra e Zhvillimit dhe Kërkimit Shkencor⁹⁸. Midis të tjerash, misioni i kësaj qendre është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të implementojë nivel të lartë kërkimi; - të sigurojë aftësimin e kërkuesve shkencorë për të arritur standardet e kërkuara; - të realizojë me nivel të lartë shkencor dhe didaktik procesin mësimor; <p>Në fund të çdo viti akademik⁹⁹, analizohet me hollësi veprimtaria e kësaj qendre si edhe problematikat e kërkimit shkencor në përgjithësi.</p>

⁹⁶ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.1, Raporte vjetore të DPP-së", ASCAL, Dok. nr.45. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁹⁷ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 38, Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit", ASCAL, Dok. nr.98. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁹⁸ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 51.1, Rregullore e Qendrës së Zhvillimit dhe Kërkimit Shkencor", ASCAL, Dok. nr.139. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁹⁹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 51.2, Raporti Vjetor i Kërkimit Shkencor 2019-2020_Kolegji Universitar LOGOS", ASCAL, Dok. nr.140. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 51.3, Raport Veprimtarie Shkencore KU-LOGOS 2018-2019", ASCAL, Dok. nr.141. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>Personeli akademik i brendshëm dhe i jashtëm, në përbërje të DPP, ka kryer kurse trajnimi me afate të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies, në kuadrin e programeve ERASMUS+ ose në bashkëpunim me institucione të tjera jashtë vendit me të cilat Kolegji Universitar "LOGOS" ka marrëveshje bashkëpunimi.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Siç edhe pranohet në RVB, Kolegji Universitar "LOGOS" nuk ka njësi përgjegjëse për trajnimin e personelit akademik. Këtë përgjegjësi të identifikimit të nevojave dhe të plotësimit të tyre nga njësia kryesore e ka marrë përsipër Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë. Ndihma e Kolegji Universitar "LOGOS" për personelin akademik konsiston në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mundësimin e trajnimit përmes programeve ERASMUS+ (apo programeve të tjera të ngjashme me të përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione partnere); - Mbështetjen e drejtpërdrejtë të personelit akademik duke mbuluar kostot e tyre financiare për botime apo për pjesëmarrje në konferenca të ndryshme shkencore jashtë vendit;
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Rregullorja e Përgjithshme¹⁰⁰ e KU "LOGOS" përcakton me hollësi detyrimet dhe përgjegjësitë e personelit akademik (neni 42), të personelit akademik të ftuar (neni 44), si edhe të personelit akademik ndihmës (neni 46). Personeli akademik dhe drejtuesit akademikë kryejnë veprimtari mësimdhënëse, kërkim shkencor ose të zbatuar, shërbime për zhvillimin e Kolegjit Universitar "LOGOS", këshillim për studentët, udhëheqje punimesh vjetore ose diplomash dhe detyra administrative.</p> <p>Personeli ndihmës-akademik me karakter mësimor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose kërkimit shkencor. Ai bën pjesë në stafin e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Këtu përfshihen laborantët, teknikët etj, sipas përcaktimeve të bëra në aktet e brendshme të Institucionit. Siç është përmendur më sipër në këtë RVJ, metodat kryesore inovative të mësimdhënies që përdoren në KU "LOGOS" janë Edupage.al dhe Microsoft Office 365.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Kushtet jashtëzakonisht specifike të viteve 2019-2021 për shkak të tërmetit dhe pandemisë së Covid-19, kanë kufizuar veprimtarinë normale të KU "LOGOS". Megjithatë, nisur edhe nga rrethanat e krijuara janë eksperimentuar dhe përdorur me sukses metoda inovative interaktive të mësimdhënies si platforma Edupage.al dhe ajo Microsoft Office 365.</p>

Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 51.4, Raport Qendra e Kërkimit Shkencor 2018-2019", ASCAL, Dok. nr.142. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁰⁰ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 5, Rregullore e Përgjithshme e KU "LOGOS", ASCAL, Dok. nr.17. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	Në fund të çdo viti akademik bëhet analiza në rang njësie bazë, më pas në rang njësie kryesore dhe në fund, në rang institucioni. Të dhënat e dala nga këto analiza, përmbledhen së bashku edhe me problematika të tjera në raportet ¹⁰¹ që nxjerr institucioni në fund të çdo viti akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVL konstatoi se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme ¹⁰² të KU "LOGOS", në nenin 95 të të cilës saktësohen se kontrolli dhe vlerësimi i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Gjithashtu, në atë nen saktësohet se kontrolli i dijeve bëhet me shkrim, me gojë, ose i kombinuar. Për çdo lëndë të veçantë, në syllabusin shoqërues ¹⁰³ të çdo lënde, jepen edhe specifika të tjera si pesha (përqindja) e secilit provim apo detyre në vlerësimin përfundimtar, literatura, temat ose pjesët e programit të lëndës për çdo provim, referencat e konvertimit të pikëve në notë etj.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Siç u theksua edhe në kriterin e mësipërm të këtij standardi, në syllabusin shoqërues ¹⁰⁴ të çdo lënde jepen tërësia e metodologjisë së testimit dhe të vlerësimit të njohurive dhe të dijeve të marra nga studentët, duke filluar nga pjesëmarrja në procesin mësimor, numri i mungesave të lejuara, mënyra e testimit (me gojë, me shkrim, apo i kombinuar), llogaritja e peshës që zë çdo komponent në notën përfundimtare, etj. Këto të dhëna bëhen të ditura për studentët, për çdo lëndë, përpara fillimit të zhvillimit të vitit akademik.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	Siç u përmend edhe në Kriterin 1 të standardit III.5, në Rregulloren e Përgjithshme ¹⁰⁵ të KU "LOGOS", në nenin 95, saktësohen se

¹⁰¹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.1, Raporte vjetore të DPP-së", ASCAL, Dok. nr.45. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.2, Raport Vjetor i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor 2018-2019", ASCAL, Dok. nr.46. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.3, Raporti Vjetor 2018-2019, Kolegji Universitar LOGOS", ASCAL, Dok. nr.47. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁰² Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 5, Rregullore e Përgjithshme e KU "LOGOS", ASCAL, Dok. nr.17. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁰³ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 16.3, "Syllabuset BA-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.32. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁰⁴ Ibid

¹⁰⁵ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 5, Rregullore e Përgjithshme e KU "LOGOS", ASCAL, Dok. nr.17. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	kontrolli dhe vlerësimi i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në forma të larmishme, si me shkrim, me gojë, ose i kombinuar. Për çdo lëndë të veçantë, në syllabusin shoqërues ¹⁰⁶ të çdo lënde, jepen edhe specifika të tjera si pesha (përqindja) e secilit provim apo detyre në vlerësimin përfundimtar, literatura, temat ose pjesët e programit të lëndës për çdo provim, referencat e konvertimit të pikëve në notë etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Referuar rregullores së DPP ¹⁰⁷ (neni 33) theksohet se <i>për programet e ciklit të parë të studimeve, kontrolli i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme</i> . Kjo gjë pasqyrohet edhe në syllabuset e lëndëve ¹⁰⁸ , në të cilat në pjesën më të madhe të tyre vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të integruar si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> - pjesëmarrja në diskutime gjatë vitit 10 pikë; - detyra e kursit 10 pikë; - provimi i ndërmjetëm 30 pikë; - provimi përfundimtar 50 pikë;
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në kushte normale të zhvillimit të procesit mësimor, në KU "LOGOS" nuk përdoret ndonjë sistem elektronik testimi dhe vlerësimi të studentëve. Ndërsa në kushtet e pandemisë, provimet janë zhvilluar dhe vlerësuar sipas platformave të përcaktuara online ¹⁰⁹ . Në KU "LOGOS" funksionojnë edhe programe të veçanta anti-plagjiaturë ¹¹⁰ .
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së	Në Rregulloren e DPP ¹¹¹ , në nenin 37/3 të saj, përcaktohet se studentët merren në provimin e lëndës ose të modulit nga jo më pak se dy pedagogë: titullari i lëndës dhe pedagogë të tjerë, të përfshirë në mësimdhënien e lëndës. Nëse titullari i lëndës ose pedagogët e

¹⁰⁶ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 16.3, "Syllabuset BA-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.32. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁰⁷ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6.1, Draft-Rregullore e DPP-së ", ASCAL, Dok. nr.19. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁰⁸ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 16.3, "Syllabuset BA-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.32. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁰⁹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 46.5, Rektorati- Urdhër- Platforma digjitale", ASCAL, Dok. nr.120. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 46.6, SA- Udhëzim për politikën e vlerësimit në distancë", ASCAL, Dok. nr.121. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹¹⁰ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 63, Zbulimi i Plagjiaturës në një detyrë", ASCAL, Dok. nr.199. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹¹¹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6.1, Draft-Rregullore e DPP-së ", ASCAL, Dok. nr.19. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>përfshirë në mësimdhënie, për arsye madhore nuk mund të marrin pjesë në provim, përgjegjësi i departamentit cakton me shkrim pedagogët që do t'i zëvendësojnë dhe njofton dekanin. Në rast pamundësie zëvendësimi, me propozim të dekanit dhe miratim të Rektorit, provimi shtyhet jashtë sezonit brenda 5 ditëve nga përfundimi i tij. Nëse moduli është zhvilluar nga një pedagog, përgjegjësi i departamentit cakton një anëtar tjetër të personelit akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Në Kolegjin Universitar “LOGOS”, testimi i vlerësimit të njohurive dhe dijeve me shkrim zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim¹¹², ndërsa në periudhën e pandemisë anonimizimi i provimeve nuk ka qenë i mundur për shkaqe që dihen.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga studimi i të gjitha rregulloreve të KU “LOGOS” rezulton se në to nuk parashikohet në mënyrë të shprehur dhënia prej pedagogëve e komenteve/feedback për rastet e vlerësimit të vazhduar përgjatë gjithë vitit. Megjithatë, nga bisedat me përfaqësues të studentëve, rezulton se pedagogët e lëndës përgjithësisht japin komente/feedback lidhur me procesin e të nxënit dhe përmirësimin e tij në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Kodi i Etikës¹¹³ i KU “LOGOS” në nenin 6 (Sjelljet e ndaluara) përcakton se studentët <i>nuk duhet të kopjojnë dhe nuk duhet të mashtrojnë gjatë procesit mësimor... dhe plagjiatura hyn në sjelljet e ndaluara</i>. Për shkelje të normave të etikës, apo për sjelljet e ndaluara, në Kodin e Etikës parashikohen edhe masa disiplinore (neni 7), të cilat jepen në mënyrë proporcionale dhe janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tërheqje vëmendje; - Paralajmërim për përjashtim; - Përjashtim nga KU “LOGOS”;
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Kodi i Etikës¹¹⁴ i Kolegji Universitar “LOGOS” në detyrimet e personelit të përcaktuara në nenin 5 të tij, thekson se personeli akademik duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të mos kërkojë dhe të mos pranojë në asnjë formë privilegje, përfitime, ndërhyrje favorizime, që kanë për qëllim marrjen e rezultateve favorizuese dhe të pamerituara prej studentëve; - Të mos bëjë dallime ndër studentë, vartës apo kolegë për shkak të njohjeve apo preferencave personale;

¹¹² Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 54.1, Sekretimi i provimeve", ASCAL, Dok. nr.154. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹¹³ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 49.1, Kodi i Etikës", ASCAL, Dok. nr.137. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹¹⁴ Ibid

	Rregulla të përcaktuara në mënyrë të qartë për zhvillimin e provimeve, oraret, mënyrën e kontrollit, të shpalljeve të rezultateve, të ankimimeve, të riprovimeve, etj, jepen në nenet 99-102 të Rregullores së Kolegjit Universitar “LOGOS” ¹¹⁵ .			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Siç u theksua në kriterin 7 të këtij standardi, rregulla të përcaktuara në mënyrë të qartë për zhvillimin e provimeve, oraret, mënyrën e kontrollit, të shpalljeve të rezultateve, të ankimimeve, të riprovimeve, etj., jepen në nenet 99-102 të Rregullores së Kolegjit Universitar “LOGOS” ¹¹⁶ . Në këtë rregullore, parashikohen edhe <i>Ankimimi për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit</i> (neni 100), si edhe <i>Ankimimi për rezultatin e provimit</i> (neni 101). Në këto dispozita parashikohen në mënyrë të hollësishme procedurat që duhet të ndiqen nga institucioni nga marrja e ankimit prej studentit, deri në dhënien e një përgjigje përfundimtare.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Në Rregulloren e KU “LOGOS” ¹¹⁷ (neni 101), por edhe në Rregulloren e Programit të Studimit ¹¹⁸ (neni 14) përcaktohet se: <i>Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim Përgjegjësit të Departamentit brenda 24 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit. Përgjegjësi i Departamentit, brenda 48 orësh, bën verifikimet e duhura duke dëgjuar mendimin e pedagogut, dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, ngre një komision ad-hoc. Ky komision përbëhet nga Përgjegjësi i departamentit, (1) një anëtar pedagog i asaj disipline ose disipline të përfaqësuar dhe pedagogu i lëndës. Komisioni ad-hoc bën verifikimin e pretendimeve të studentit duke rivlerësuar tezën e provimit dhe përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit të cilin, ia komunikon studentit brenda (3) tre ditëve. Rezultati i rishqyrtimit duhet t’i njoftohet me shkrim pjesëmarrësit të provimit, duke e shoqëruar me informacionin e nevojshëm. Vendimi i komisionit ad-hoc, është përfundimtar. Studenti nuk ka të drejtë të paraqesë ankesë kundër vlerësimit të komisionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

¹¹⁵ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 5, Rregullore e Përgjithshme e KU “LOGOS”, ASCAL, Dok. nr.17. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹¹⁶ Ibid

¹¹⁷ Ibid

¹¹⁸ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimit “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Siç është theksuar edhe më sipër në këtë RVJ, në Rregulloren e Programit të Studimit¹¹⁹ për “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, theksohet se <i>misioni</i> i programit të studimit “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor; – të formojë specialistë të lartë në fushën e arsimit parashkollor në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit; – të krijojë mundësi për aftësimin metodik, pedagogjik dhe edukues të studentit; <p>Ndërsa rezultatet kryesore të pritshme të të nxënit të programit të studimit “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, për studentët që përfundojnë me sukses programin, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të shpjegojnë konceptet themelore në fushën e edukimit parashkollor; – të reflektojnë mbi filozofinë e edukimit tradicional dhe atë të avancuar me “në qendër fëmija”; – të njohin dhe kuptojnë procesin e edukimit parashkollor, familjar dhe parashkollor të institucionalizuar; – të reflektojnë për vlerat e edukimit parashkollor në shoqëri, dhe forcojnë partneritetin prindër-fëmijë dhe komunitet-fëmijë; – të formojnë një filozofi personale të avancuar për edukimin parashkollor;
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Sipas RVB –së, në Planin mësimor¹²⁰ të Programit të Studimit "Bachelor" në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” parashikohet edhe zhvillimi i lëndëve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> – <i>Përdorim kompjuteri</i> (viti i parë), përmes zhvillimit të të cilës zhvillohen aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit. Gjithashtu, institucioni vendos në dispozicion të studentëve edhe materiale të tjera ndihmëse për rritjen e kompetencave në këtë fushë.¹²¹ – <i>Edukatë Qytetare dhe Metodikë</i> (viti i parë), <i>Etikë</i> (viti i dytë) dhe <i>Zhvillim Social</i> (viti i tretë), përmes zhvillimit të të cilave mundësohet rritja e kompetencave në fushën humane sociale. – <i>Gjuhë dhe Komunikim</i> (viti i parë), përmes të cilës mundësohet rritja e kompetencave në fushën e gjuhës dhe komunikimit.

¹¹⁹ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimit “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹²⁰ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 13, Dosja e plotë e Programit të Studimit me elementët përbërës të tij", ASCAL, Dok. nr.26. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹²¹ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 38, Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit", ASCAL, Dok. nr.98. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	– Gjuhë e Huaj (viti i parë dhe i dytë), përmes të cilës mundësohet rritja e kompetencave në fushën e gjuhëve të huaja.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Kompetencat dhe aftësitë që fitojnë studentët në fund të çdo lënde, për Programin e Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" tregohen kryesisht me rezultatet e arritura prej studentëve përmes formave të ndryshme të vazhdueshme të testimit, si edhe përmes arritjeve në provimin përfundimtar. Analiza më të hollësishme, për rezultatet që arrijnë studentët në fund të çdo viti akademik, bëhen në raportet vjetore të DPP.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Rezultoni se kurrikula në përgjithësi dhe syllabuset në veçanti, për të gjitha lëndët e Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" janë rishikuar ¹²² në atë masë që lejon ligji, në përgjigje të problematikave që kanë dalë gjatë zbatimit të tyre.
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Për shkak se Programi i Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" e ka zanafillën në vitin akademik 2018-2019, si edhe për shkak të pengesave dhe problematikave ligjore të krijuara nga situata pandemike, nuk ka qënë e mundur realizimi i orëve të hapura apo seminareve të zgjeruara me prani fizike.
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Gjithë stafi akademik, i angazhuar në këtë program studimi, i ka hartuar syllabuset lëndore duke mbajtur parasysh nivelin e zhvillimit të kompetencave që duhet të zotërojë nxënësi në arsimin parashkollor, duke respektuar karakteristikat e zhvillimit moshor dhe të të nxëniet të fëmijëve 3-6 vjeç. ¹²³
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Nga shqyrtimi i RVB-së së KU "LOGOS", por edhe nga bisedat me stafin akademik dhe studentët, konstatohet se një nga elementët kryesorë të procesit mësimor në institucion është diskutimi dhe puna në grup për interpretimin apo zgjidhjen e çështjeve të caktuara, shkëmbimit të përvojave të ndërsjellta, si edhe fokusimi mbi çështje jetësore.
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Ashtu siç edhe pranohet në RVB të paraqitur nga KU "LOGOS", pranë institucionit funksionon edhe Qendra për Zhvillimin dhe Kërkimin Shkencor ¹²⁴ , e cila ka si qëllim të organizojë veprimtarinë kërkimore-shkencore të stafit akademik dhe të studentëve të KU "LOGOS", duke siguruar një nivel të lartë kërkimi dhe shpërndarje me cilësi të rezultateve të tij. Aktivitetet e kësaj qendre pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur në raportet vjetore ¹²⁵ të qendrës.

¹²² Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 44, Procedurat për Ndryshimin e Kurrikulës", ASCAL, Dok. nr.111. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹²³ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 16.3, "Syllabuset BA-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.32. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹²⁴ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 51.1, Rregullore e Qendrës së Zhvillimit dhe Kërkimit Shkencor", ASCAL, Dok. nr.139. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹²⁵ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 51.2, Raporti Vjetor i Kërkimit Shkencor 2019-2020_Kolegji Universitar LOGOS", ASCAL, Dok. nr.140. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Siç edhe pranohet në RVB e paraqitur nga KU “LOGOS”, por edhe nga bisedat me stafin akademik dhe përfaqësues të studentëve, rezulton se Institucioni ka mbështetur në mënyrë modeste financiarisht personelin akademik për promovimin e tyre profesional, ndërsa mbështetja e studentëve gjykohet sipas rastit dhe ka qënë përgjithësisht modeste.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Siç edhe pranohet në RVB e paraqitur nga KU “LOGOS”, ka një nivel të kënaqshëm bashkëpunimi të personelit akademik të Kolegjit Universitar “LOGOS” për shkak të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të huaja që kanë në objektivin e tyre fushën e edukimit. Ndërsa mobiliteti i studentëve, siç përmendet edhe në RVB, ka qënë në nivel të ulët, kryesisht për shkak të pandemisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Sipas Rregullores së FSHHKGJ ¹²⁶ (neni 28), përcaktohet se <i>Kriter për zgjedhjen e punimit të diplomës, Senati i Kolegjit Universitar “LOGOS” ka vendosur notën mesatare 7.5 e lart.</i> Procedura të hollësishme për mbrojtjen e diplomës apo të dhënies së provimit përfundimtar jepen në Rregulloren e DPP ¹²⁷ . Sipas kësaj rregulloreje (neni 41, 42), studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me <i>provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome.</i> Fakultetet përkatëse, brenda dymbëdhjetë muaj para datës së parashikuar të mbrojtjes së diplomës, u bëjnë të njohur studentëve programin e provimit të përgjithshëm përfundimtar dhe caktojnë temat e punimit të diplomës.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Sipas Rregullores së DPP-së ¹²⁸ (neni 44), punimi i diplomës përcaktohet në mënyrë të tillë që të përfshijë domosdoshmërisht eksperimentin ose kërkim apo vjelje të dhënash në terren. Punimi i diplomës është i lidhur me disiplinat e përafërta dhe mund të jetë me natyrë individuale ose kolektive (dy-tre studentë). Në rastet e punimeve kolektive, studentët kanë të ndarë çështjet që do të trajtojnë, duke

Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 51.3, Raport Veprimtarie Shkencore KU-LOGOS 2018-2019", ASCAL, Dok. nr.141. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 51.4, Raport Qendra e Kërkimit Shkencor 2018-2019", ASCAL, Dok. nr.142. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹²⁶ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor", ASCAL, Dok. nr.18. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹²⁷ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6.1, Draft-Rregullore e DPP-së", ASCAL, Dok. nr.19. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹²⁸ Ibid

	<p>respektuar një ndarje afërsisht të barabartë të volumit të punës që do të kryejnë. Punimet e diplomës dhe specialistët që do të udhëheqin punimin e tyre, përcaktohen nga departamenti përkatës dhe miratohen nga dekani i fakultetit. Në përcaktimin e punimeve të diplomës, departamentet dhe fakultetet bashkëpunojnë me qendrat kërkimore shkencore të Kolegjit Universitar “Logos” si dhe me institucione të tjera publike apo private që punojnë në fushat përkatëse. Studenti ka të drejtë të shprehë dëshirën e tij në lidhje me punimin e diplomës që kërkon të zhvillojë dhe udhëheqësin e tij. Ai mund të propozojë edhe vetë një punim tjetër diplome së bashku me udhëheqësin përkatës. Ndërsa në nenin 47 të Rregullores së DPP-së, përcaktohet se KU “LOGOS” organizon dy sesione për provime te përgjithshme të formimit: në verë dhe në vjeshtë. Sesionet shpallen nga Rektori i Kolegjit Universitar «Logos». Datat e zhvillimit të provimeve sipas sesioneve përkatëse, përcaktohen nga Dekani i fakultetit. Programi i provimit të formimit është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Provimi realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga pedagogë efektivë dhe të jashtëm, të fushave që mbulon programi i provimit. Anëtarët e komisionit propozohen nga departamentet përkatëse dhe miratohen nga dekani. Kryetari i komisionit caktohet nga dekani. Ai respekton në çdo rast, për secilin student procedurën dhe rregullat përkatëse të vendosura nga dekanati.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në nenin 47 të Rregullores¹²⁹ së DPP-së, Komisioni i Posaçëm për administrimin e provimit final përbëhet nga 5 anëtarë që janë pedagogë të fushave kryesore të programit të studimit. Teza e provimit hartohet në bashkëpunim midis tyre duke u kujdesur që të përmbajë pyetje thelbësore nga të gjitha lëndët/modulet e zhvilluara përgjatë tre viteve të studimit. Teza e provimit, sikurse u theksua edhe më sipër, hartohet në bazë të <i>bankës</i> së pyetjeve, e cila u bëhet e njohur paraprakisht studentëve. Ndërsa vlerësimi i temës së diplomës bëhet përmes përdorimit të sistemit me pikë, i cili vlerëson me anë të pikëzimit elementët kryesorë të temës së paraqitur nga studenti.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Ashtu siç është përmendur edhe në Kriterin 2 të këtij standardi (III/8), Rregullorja e DPP-së¹³⁰ (neni 44), përcakton se punimet e diplomës do të udhëhiqen nga specialistë të departamentit përkatës të cilët miratohen nga Dekani i fakultetit. Në përcaktimin e punimeve të diplomës, departamentet dhe fakultetet bashkëpunojnë me qendrat kërkimore shkencore të Kolegjit Universitar “Logos” si edhe me institucione të tjera publike apo private që punojnë në fushat përkatëse. Studenti ka të drejtë të shprehë dëshirën e tij në lidhje me punimin e diplomës që kërkon të zhvillojë dhe udhëheqësin e tij. Institucioni ka</p>

¹²⁹ Ibid

¹³⁰ Ibid

	<p>nxjerrë edhe udhëzues të posaçëm¹³¹ lidhur me mënyrën e punimit, të asistimit prej pedagogëve, si edhe të mbrojtjes së diplomës.</p> <p>Ndërsa teza e provimit përfundimtar përmban pyetje thelbësore nga të gjitha lëndët/modulet e zhvilluara përgjatë tre viteve të studimit. Teza e provimit, sikurse u theksua edhe më sipër, hartohet në bazë të bankës së pyetjeve, e cila u bëhet e njohur paraprakisht studentëve. Teza e provimit përmban pyetje nga të gjitha fushat që përfshihen në programin e provimit. Pësha specifike që kanë pyetjet e çdo fushe në tezën e provimit përcaktohet nga dekanati. Fondi i pyetjeve duhet të jetë rreth 10 herë më i madh se numri përkatës i pyetjeve që përmbahen në fushën përkatëse. Tematika orientuese e provimit të formimit hartohet nga anëtarët e komisionit, të cilët i përzgjedhin pyetjet nga fondi i krijuar, në përputhje me peshën specifike të çdo fushe.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nga bisedat me përfaqësues të studentëve, apo edhe nga komunikimi me stafin akademik, rezultojnë se pedagogët, sipas moduleve që ofrojnë, asistojnë studentët gjatë orëve praktike në mjediset e Kolegjit Universitar "LOGOS" apo në orët praktike që ata realizojnë në institucionet pritëse me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. Për vitet 2019-2020 ky proces ka patur kufizimet e veta për shkak të pandemisë.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Ashtu siç është përmendur më sipër në këtë RVJ, Rregullorja e DPP-së¹³² (neni 44), përcakton se punimet e diplomës do të udhëhiqen nga specialistë të departamentit përkatës të cilët miratohen nga Dekani i fakultetit. Në përcaktimin e punimeve të diplomës, departamentet dhe fakultetet bashkëpunojnë me qendrat kërkimore shkencore të Kolegjit Universitar "Logos" si dhe me institucione të tjera publike apo private që punojnë në fushat përkatëse. Studenti ka të drejtë të shprehë dëshirën e tij në lidhje me punimin e diplomës që kërkon të zhvillojë dhe udhëheqësin e tij. Institucioni ka nxjerrë edhe udhëzues të posaçëm¹³³ lidhur me mënyrën e punimit, të asistimit prej pedagogëve, si edhe të mbrojtjes së diplomës.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në nenin 46 të Rregullores së DPP¹³⁴-së, përcaktohet se <i>në përfundim të çdo seance mbrojtjeje ditore, kryetari i komisionit, në prani të anëtarëve, i komunikon çdo diplomanti notën me të cilën është vlerësuar punimi i tij.</i> Nota është mesatarizim i vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit. Ajo regjistrohet në procesverbalin e mbrojtjes së diplomave. Procesverbali nënshkruhet nga gjithë anëtarët e komisionit. Në rast se punimi i studentit vlerësohet me notë negative,</p>

¹³¹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 61, Punimi Temës së Diplomës", ASCAL, Dok. nr.197. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹³² Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6.1, Draft-Rregullore e DPP-së ", ASCAL, Dok. nr.19. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹³³ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 61, Punimi Temës së Diplomës", ASCAL, Dok. nr.197. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹³⁴ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6.1, Draft-Rregullore e DPP-së ", ASCAL, Dok. nr.19. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>ai mund të rimbrojë të njëjtin punim ose të mbrojë një punim të ri brenda një periudhe jo më vonë se tre vjet. Gjatë periudhës trevjeçare nga koha e përfundimit të studimeve të plota, diplomanti ka të drejtë të mbrojë punimin e tij deri në dy herë. Nëse në të dy rastet diplomanti është vlerësuar nga komisioni me notë negative ose nuk paraqitet për të bërë mbrojtjen e punimit brenda afateve maksimale (trevjeçare), atëherë student humbet të drejtën e diplomimit. Ndërsa në nenin 47 të Rregullores së DPP-së, theksohet se me mbarimin e provimit komisioni shpall përgjigjen e provimit në mjediset publike. Korrigjimi i tezës bëhet nga komisioni, i cili shënon pikët e fituara në faqen e sekretimit. Heqja e sekretimit bëhet nga komisionin në prani të dekanit. Rezultatet paraprake shpallen në mjediset publike të fakultetit. Përgjigjet ruhen për një vit në arkivën e fakultetit. Rezultatet e provimit të formimit duhet të jepen brenda pesë ditëve pune nga dita e kryerjes së provimit.</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Sipas nenit 114 të Rregullores¹³⁵ së KU "LOGOS", studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën (me punim diplome ose provim përfundimtar/të përgjithshëm), pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me suplementin e diplomës. Formatit i diplomës dhe suplementi i saj bëhet sipas formatit të miratuar¹³⁶ nga MASR.</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Procedura e konfirmimit të dokumentacionit akademik të studentit¹³⁷, në Kolegjin Universitar "LOGOS", kryhet kur kërkohet nga vetë studenti, ish-studenti ose institucioni i interesuar për dokumentacionin e studentit. Kolegji Universitar "LOGOS" lëshon konfirmim për dokumentet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> diplomë pasqyrë e arritjeve akademike suplement i diplomës plan mësimor i programit përkatës të studimit programe mësimore të lëndëve <p>Dokumentet, që verifikohen me qëllim konfirmimi, duhet të jenë të lëshuara nga njësia kryesore e Kolegjit Universitar "LOGOS" dhe konkretisht për Programin e Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" dokumentet lëshohen nga Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor.</p>
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar</p>	<p>Sipas nenit 15 të Rregullores së Arkivës së Institucionit¹³⁸, afati i ruajtjes së dokumenteve në fondin e arkivës që i përketin të dhënave</p>

¹³⁵ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 5, Rregullore e Përgjithshme e KU "LOGOS", ASCAL, Dok. nr.17. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹³⁶ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 14, Modeli Diplomës dhe Suplementit të Diplomës", ASCAL, Dok. nr.27. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹³⁷ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 46.9, Urdhër nr. 8, datë 21.07.2020 Për procedurën e konfirmimit të dokumentacionit akademik të studentëve, të lëshuar nga Kolegji Universitar "LOGOS", ASCAL, Dok. nr.125. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹³⁸ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 55, Rregullore Arkiva-Protokolli", ASCAL, Dok. nr.161. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	për studentët është i përjetshëm, ku përfshihen regjistrat e Amzës (NIM), librat themeltar të studentëve, librat e arritjeve akademike, librat e lëshimit të diplomave/certifikatave. Lëshimi i kopjeve të vërtetuara të dala nga arkiva e institucionit bëhet duke respektuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe legjislacionin që rregullon marrëdhëniet në fushën e arkivave.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.	Nga shqyrtimi i RVB dhe takimet e organizuara gjatë vizitës në Kolegj, konstatoam se institucioni mbledh dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit akademik sipas nevojave të propozuara nga departamenti. Drejtoria e komunikimit dhe burimeve njerëzore menaxhon dosjet e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ si dhe harton dhe ndjek procedurat për rekrutimet e reja. Ne patëm mundësi të shikojmë dosjet e personelit dhe të diskutojmë mënyrën e rekrutimit të stafit akademik në kolegj dhe vërejmë se institucioni mbledh dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit akademik, të rekrutuar, sipas nevojave të propozuara nga departamenti. Zyra e Burimeve Njerëzore menaxhon dosjet e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, si dhe harton dhe ndjek procedurat për rekrutimet e reja ¹³⁹ . Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë mbledh, ruan dhe përditëson angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik të përfshirë në program dhe personat përgjegjës për

¹³⁹Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 11, Politikat dhe Procedurat e Burimeve njerëzore", ASCAL, Dok. nr.24. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	organizimin e programit të studimit “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”. ¹⁴⁰
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Evidentohet se institucioni ka procedura të qarta dhe transparente për rekrutimin e stafit. Thirrja për rekrutime, e bazuar te nevojat e secilit departament, shpallet në Website të institucionit ¹⁴¹ dhe në rrjete sociale ¹⁴² . Rregullorja e institucionit ¹⁴³ dhe Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor ¹⁴⁴ . Për aplikantët ngrihet komisioni vlerësimi, i cili merr vendimin në bazë të kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe në aktet e brendshme të rregullores së Kolegjit Universitar “Logos”. Vendimi më pas ndiqet deri në momentin e rekrutimit përfundimtar ¹⁴⁵
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriterëve të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	U konstatua se në çdo fillim viti akademik, Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë paraqiste nevojat e njësisë për staf akademik, mbështetur në plan ngarkesën ¹⁴⁶ , e cila miratohej në Dekanat dhe i çohej për miratim Senatit akademik dhe Bordit të Administrimit, shoqëruar me arsyetimet e duhura. Më pas Institucioni hartonte procedura e kriterëve specifike për rekrutimin e personelit, të cilat ishin pjesë e akteve rregullatore dhe ato bëheshin publike, në bazë të nevojave të identifikuar. ¹⁴⁷
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterëve të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën,	Referuar RVB –se dhe vizitës në institucion GVJ konstatuam se praktika për përzgjedhjen e personelit akademik kryhej nga një komision ad-hoc i ngritur nga Rektori i Kolegjit Universitar “Logos” ose Dekani i FSHHKGJ, me 5 anëtarë: <ul style="list-style-type: none"> - 3 përfaqësues nga vetë departamenti, - 1 përfaqësues i dekanatit, - 1 përfaqësues i rektoratit.

¹⁴⁰Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 19, Tabela 2, Të dhënat për personelin akademik në Programin e Studimit", ASCAL, Dok. nr.35. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴¹ <http://www.kulogos.edu.al/al/punesime.html>

¹⁴² Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 58.4, Paketë Rekrutimi dhe përzgjedhjeje për personelin akademik me kohë të pjesshme", ASCAL, Dok. Nr.185. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq> dhe Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimit “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴³Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor", ASCAL, Dok. nr.18. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴⁴Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6.1, Draft-Rregullore e DPP-së ", ASCAL, Dok. nr.19. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴⁵ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 58.4, Paketë Rekrutimi dhe përzgjedhjeje për personelin akademik me kohë të pjesshme", ASCAL, Dok. nr.185. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴⁶ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 19, Tabela 2, Të dhënat për personelin akademik në Programin e Studimit", ASCAL, Dok. nr.35. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq> dhe Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi Ligji 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ngarkesa Mësimore vjetore Pedagogjia dhe Psikologjia 2020-2021”, ASCAL, Dok. nr.203. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴⁷ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 58.4, Paketë Rekrutimi dhe përzgjedhjeje për personelin akademik me kohë të pjesshme", ASCAL, Dok. Nr.185. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	2 prej këtyre anëtarëve kërkohet të jenë me titull shkencor akademik. Zyra e Arkiv-Protokollit dhe e Burimeve Njerëzore, ndiqte të gjitha procedurat dhe administronte ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të Departamentit si dhe arkivonte konform rregullave ligjore dosjet përkatëse për çdo anëtar të PAE dhe PAK dhe marrëveshjet kontraktuale të organizimit të kohës së punës të stafit akademik ¹⁴⁸ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficientë dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Nga vizita e mjedisve fizike të institucionit konstatoam se pedagogët kanë mjedise të përshtatshme për kryerjen e detyrave të tyre. Secilit pedagog i takon një hapësirë prej 9,4 m ^{2/149} . Zyrat janë të pajisura me mobilje dhe kompjutera dhe kanë akses në printera dhe lehtësira pajisjesh për punën e përditshme. Ka dhe hapësirë të mjaftueshme dhe për këshillimin e studentëve në kushte konfidencialiteti.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Zyra e Burimeve Njerëzore e institucionit administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të departamentit. Ajo arkivon dosjet përkatëse të personelit akademik, si dhe marrëveshjet e nënshkruara me stafin akademik në përfundim të gjithë procesit të rekrutimit ¹⁵⁰ . Po ashtu dhe Departamenti përditëson në mënyrë të vazhdueshme të dhënat që lidhen me aktivitetin kërkimor të stafit akademik, si dhe ofron mbështetje

¹⁴⁸ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 11, Politikat dhe Procedurat e Burimeve njerëzore", ASCAL, Dok. Nr.24. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq> Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 55, Rregullore Arkiva-Protokollit", ASCAL, Dok. Nr.161. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq> /

Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 58.2, Kontrata e Punës për personelin ndihmës akademik me karakter administrativ dhe Kontratë e punës për administratën", ASCAL, Dok. Nr.183. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq/> Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 58.3, Kontratë Individuale e Punës për Personelin Akademik të Kolegjit Univeristar LOGOS", ASCAL, Dok. nr.184. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴⁹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 34.1, Infrastruktura, DPP", ASCAL, Dok. Nr.66. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq> dhe Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 34.2, Infrastruktura FSHHKGJ", ASCAL, Dok. nr.67. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵⁰ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 58.5, Statistika lidhur me formimin dhe kualifikimin e Personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshme", ASCAL, Dok. Nr.186. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq> dhe Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 58.9, Kualifikimet e Stafit Akademik", ASCAL, Dok. nr.190. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	tërësore ose pjesore financiare për pjesëmarrje nëpër konferenca shkencore, fleksibilitet për kohën e tyre për zhvillimin akademik dhe profesional të tyre, mundësi në databaza dhe materiale kërkimore shkencore nga biblioteka e institucionit, si dhe pjesëmarrjeë në trajnime kombëtare dhe ndërkombëtare për zhvillimin e tyre. ¹⁵¹ .			
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Institucioni ka hartuar një Udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies online. Departamenti ka identifikuar nevojat për trajnim të stafit dhe janë organizuar trajnime për përdorimin e teknologjive të reja në mësimdhënies, si dhe është realizuar ngritja e sistemit të brendshëm informues në platformën “Microsoft Teams”. ¹⁵² .			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë ka burime njerëzore të përshtatshme për përbushjen e objektivave të programit të studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor. Stafi është i kualifikuar dhe me ekspertizë të drejtpërdrejtë me fushën e programit të studimit ¹⁵³ . Nga ana tjetër zhvillohet dhe vlerësim i vijueshëm i stafit akademik lidhur me përbushjen e objektivave të programit të studimit nëpërmjet anketimit të studentëve. ¹⁵⁴ .			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë	Institucioni e përbush këtë kriter nga pikëpamja e sipërfaqes dhe mjediseve të nevojshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike dhe praktike në përputhje me

¹⁵¹ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 35.11, Seminar Zhvillimi për Personelin Akademik", ASCAL, Dok. Nr.93. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq> dhe Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 35.9/35.9, Trajnime 2, 2018-2019", ASCAL, Dok. Nr.90/91. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵² Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 35.1, Grupi Kërkimor i DPP", ASCAL, Dok. Nr.83. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq> dhe Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 35.2, Objektiva kërkimore individuale, DPP", ASCAL, Dok. Nr.84. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq> dhe Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 38, Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit", ASCAL, Dok. nr.98. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵³ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi Ligji 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ngarkesa Mësimore vjetore Pedagogjia dhe Psikologjia 2020-2021”, ASCAL, Dok. nr.203. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵⁴ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 33, Pyetësor i Stafit akademik dhe ndihmës akademik", ASCAL, Dok. nr.65. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>natyrën specifike të programit të studimit dhe modulet përkatëse. Godina ku gjendet Fakulteti dhe Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë ka hapësira të mjaftueshme për numrin e studentëve (14 në të tre vitet) që ka aktualisht. GVJ vizitoi mjediset e godinës dhe konfirmon se ato plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral dhe ishin të pajisura me sistem ngrohje. Biblioteka po ashtu ishte në një ambjent të përshtatshëm me ajër dhe hapësira studimi të mjaftueshme.^{155, 156.}</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ konfirmoi në vizitën e tij në institucion që auditorët ishin të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme (tabela, videoprojektor dhe PC) për një proces efektiv mësimor në përputhje me qëllimet e programit.^{157.} Gjatë pandemisë mësimdhënia online u zhvillua nëpërmjet platformës (EduPage), si dhe nga një platformë ndërmjetësuese e komunikimit midis aktorëve të ndryshme të proceseve të këtij programi studimi (MS-TEAMS).</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Për aktivitetet e programit janë gjithashtu në dispozicion Laboratori i kompjuterëve, Atelieja për edukimin që mundëson zbatimin e metodologjisë 'Montesori' bazuar në lojë, kreativitet dhe arte vizuale, e cila frymëzohet nga modeli i i suksesshëm i Reggio Emilias, një mjedis fizik, me kompjutera, projektor, tabela për varjen e fotove, vegla muzikore, mjete për të pikturuar, kavaletë, një skenë e vogël për të recituar, mikrofonta, perde për errësim, tavolina, karrige e stola, raftë. Në përdorim nga Departamenti për këtë program janë dhe sallat e leksioneve, të pajisura me videoprojektorë.^{158.}</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së</p>	<p>GVJ konstatoi se Institucioni ka një laborator informatike dhe një atelie për mbështetjen e zbatimit të programit. Po ashtu, mundësitë e platformës elektronike të komunikimit MS TEAMS u krijojnë lehtësi studentëve në proceset e të nxënies.^{159.}</p>

¹⁵⁵ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 34.1, Infrastruktura, DPP", ASCAL, Dok. Nr.66. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq> dhe Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 34.2, Infrastruktura FSHHKGJ", ASCAL, Dok. nr.67. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵⁶ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 34.1, Infrastruktura, DPP", ASCAL, Dok. Nr.66. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq> dhe Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 34.17, Kërkesa për Atelie-2019", ASCAL, Dok. nr.82. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵⁷ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 34.1, Infrastruktura, DPP", ASCAL, Dok. Nr.66. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq> dhe Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 34.2, Infrastruktura FSHHKGJ", ASCAL, Dok. nr.67. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵⁸ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 34.4, Inspektim Teknik Kampus", ASCAL, Dok. Nr.69. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq> dhe Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 34.8, Relacion mbi Infrastruktura 2020", ASCAL, Dok. nr.73. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵⁹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 34.1, Infrastruktura, DPP", ASCAL, Dok. Nr.66. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq> dhe Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 34.2, Infrastruktura FSHHKGJ", ASCAL, Dok. nr.67. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

programit/ eve të studimit që ofron.				
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Referuar vizitës në Institucion konstatuam se institucioni ka mjedis të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e procesit mësimor dhe një pjese të praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike në funksion të programit. Institucioni ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë e Tiranës, me Fondacionin “Frymë Dashurie”, etj. për realizimin e praktikave mësimore të studentëve. ¹⁶⁰ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedis mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedis të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Rezulton se, nga vëzhgimi i mjediseve fizike të institucionit, në dispozicion të studentëve të këtij programi studimi ishin dy biblioteka në mjedis fizike, si: Bibliotekën Nr. 1 “Logos” në kampusin kryesor në Tiranë dhe Bibliotekën Nr. 2. “Ngjallja” në kampusin e Shën Vlashit, Durrës, si dhe një bibliotekë digjitale ¹⁶¹ . Evidentohet nga dokumentacioni i bibliotekës dhe nga komunikimi me studentët drejtpërdrejt (njëkohësisht dhe online) se ata kanë të drejtë të anëtarësohen në bibliotekë dhe të përdorin literaturën, si fizike ashtu edhe atë elektronike, kurse gjatë situatës Covid-19, përdorimi i bibliotekës fizike nga ana e studentëve ka qenë i kufizuar.

¹⁶⁰ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 27, Marrëveshjet e bashkëpunimit", ASCAL, Dok. Nr.43. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq> dhe Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 28, Korrespondenca të KU-LOGOS në kuadër të zgjerimit të rrjetit të bashkëpunëtorëve", ASCAL, Dok. nr.44. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁶¹ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 57.1, Biblioteka e Kolegjit Univeristar LOGOS (Pjesa përshkrimore)", ASCAL, Dok. Nr.174. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq> dhe Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 57.2, Rregullore e miratuar e Bibliotekës_13.02.2019", ASCAL, Dok. nr.175. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në bibliotekën e institucionit rezulton se ajo ka hapësirë të mjaftueshme për studim. Nga shqyrtimi i inventarit të saj dhe vëzhgimit të literaturës e sistemuar në raftë evidentohet se ajo disponon literaturë të domosdoshme që lidhet me fushat kurrikulare të programit të studimit, përmbante literaturë plotësuese, revista shkencore¹⁶² në gjuhë shqipe, greke dhe angleze. Po ashtu nga punonjësja e bibliotekës u prezantua në kompjuter dhe lista e librave online, të cilat u dërgoheshin studentëve dhe kjo mënyrë ishte përdorur gjatë mësimit online. Nga biseda në bibliotekë, nga shqyrtimi i RVB, por dhe nga shikimi i videos prezantuese të instituicionit evidentohet dhe biblioteka tjetër në Shën Vlash.</p> <p><i>GVJ rekomandon që biblioteka të pajiset me më shumë literaturë të 3-4 viteve të fundit, e cila të lidhet me përmbajtjen e programit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga punonjësja e bibliotekës u demonstrua online në kompjuter munsësia që instituioni ka për akses pa pagesë në literaturën online të bibliotekës ndërkombëtare 'Questia Online' Library, në të cilën kanë mundësi të futen studentët dhe stafi akademik.¹⁶³</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Nga vizita në bibliotekë u vu re se ajo dispononte kompjutera, në të cilët studentët mund të përdorin programet e ndryshme të Microsoft Office. Gjithashtu na u paraqit në kompjuterin e bibliotekës dhe katalogu elektronik http://lib-orthodoxalbania.org, i cili lehtëson studentët dhe stafin akademik për të gjetur sa më shpejt informacionin që disponon fondi i saj.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Biblioteka ka hartuar një strategji, të shndërruar në një plan të detajuar veprimi për përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit të studimit¹⁶⁴.</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit</p>	<p>Nga takimi me studentët u evidentua se biblioteka frekuentohej nga ata dhe pedagogët gjatë gjithë vitit akademik dhe është në funksion të studentëve nga e hëna në të premte, gjatë orareve</p>

¹⁶² Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 57.4, Kartela e Regjistrimit në Bibliotekën e KU-LOGOS", ASCAL, Dok. Nr.177. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 57.6, Lista e titujve për arsimin parashkollor 2018- Maj 2021 në Bibliotekën LOGOS", ASCAL, Dok. Nr.179. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 57.7, Literaturë mbështetëse në Bibliotekën NGJALLJA për programin "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.180. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁶³ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 57.5, Llogaria në QUESTIA", ASCAL, Dok. Nr.178. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>;

¹⁶⁴ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 57.3, Strategjia e Bibliotekës 2019- 2023", ASCAL, Dok. nr.176. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	08:00-20:00. Gjatë pandemisë punonjësit e saj kanë lehtësuar studentët për dërgimin e literaturës online.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u prezantua sistemi 'Edupage' në kompjuter, i cili siguron informacion dhe komunikim të studentët për të dhënat personale, vlerësimet e tyre, prezencën në mësim, etj. Këto të dhëna ruhen në format xlsx si backup i shpërndarë në kompjutera lokalë dhe në cloud ¹⁶⁵ . Ky sistem ruante, mundëson dhe gjeneron statistika të shumëllojshme, vjetore që lidhen me programet e studimit, ciklet e shkollimit, numrin e studentëve, regjistrimet, transferimet dhe çregjistrimet, numrin e krediteve të fituara nga secili student/e, si dhe të dhënat e atyre që diplomoheshin.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	U konstatua se nga vëzhgimi i ndërtimit, funksionimit dhe përmbajtjes së sistemit 'Edupage', ai përdoret dhe për të ruajtur informacionin e domosdoshëm për secilin pjesëtar të stafit, si dhe materiale mësimore, ku dhe Departamenti ¹⁶⁶ që mbulon programin kishte në platformë të paraqitur veprimtarinë shkencore-kërkimore të stafit, ku dhe për këtë rast aplikohet ruajtja e informacionit në kopje xlsx të shpërndara në kompjutera lokalë dhe në cloud ¹⁶⁷ .
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të	Rezulton se sistemi i menaxhimit online funksiononte nëpërmjet sistemit "Edupage" dhe "Teams" dhe në to ruhej dokumentacioni i duhur për secilin student/e (të dhëna për regjistrimet,

¹⁶⁵ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 38.1, Shembuj nga EduPage-studentët", ASCAL, Dok. Nr.98. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 38.3, Akses në EduPage IV.5.3", ASCAL, Dok. nr.100. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁶⁶ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.3, Raporti Vjetor 2018-2019, Kolegji Universitar LOGOS", ASCAL, Dok. Nr.47. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.4, Raporti Vjetor 2019-2020, Kolegji Universitar LOGOS", ASCAL, Dok. nr.48. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁶⁷ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 38.2, Shembuj nga EduPage-Stafi", ASCAL, Dok. Nr.99. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	diplomimet), si dhe për stafin akademik ¹⁶⁸ . Në sistem mund të futeshe duke kombinuar ‘username/password’ dhe kishin mundësi të futeshin në të stafi akademik dhe vetëm ata studentë që ishin të matriculuar ¹⁶⁹ . Nga takimi në sekretarinë mësimore u konstatua se ruhej çdo gjë dhe në versionin fizik/të printuar.			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	U konstatua se Sistemi i menaxhimit zhvillohej nëpërmjet platformës ‘Microsoft 365’ me anë të ‘Microsoft Teams’. Kjo platformë u jep mundësi ndërveprimi pedagogëve dhe studentëve për të marrë dhe dërguar materiale mësimore dhe për të zhvilluar mësimin online. Platforma jepte mundësi për përdorim të aplikacioneve Windows, MacOS, Linux, Android. Mund të futeshe në të, duke kombinuar ‘username/password’. Nga prezantimi i saj nga sekretaria mësimore rezultoi se platforma përdorej dhe për regjistrime, për grafikun dhe njoftimin e provimeve, si dhe evidentoihej qartë se mund të futej në të secili/a student/e ¹⁷⁰ .			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Rezultoi se sistemi i menaxhimit përdorej në vijimësi nga stafi dhe studentët nëpërmjet ‘Edupage’ dhe ‘Microsoft 365’, por dhe me anë të adresës së emailit, me domain të institucionit, si nga stafi dhe studentët. Në sistem identifikoheshin qartë të dhëna dhe statistika të detajuara mbi veprimtaritë që kryhej nga stafi akademik dhe administrativ ¹⁷¹ .			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Evidentohet se Kolegji Universitar “Logos” disponon faqen e tij, online zyrtare, http://www.kulogos.edu.al . Nga vëzhgimi i saj rezultoi se aty janë postuar dokumente të rëndësishme institucionale (statuti, rregullore, etj) organizmat drejtuese, stafet akademike, programet e studimit, si dhe lajmërimi të shumta që lidhen me grupet e interesit të programit të studimit bachelor në Mësuesi për Arsim Parashkollor. Të gjitha materialet e publikuara në faqen zyrtare, të internetit janë të publikuara në shqip dhe në anglisht. ¹⁷² .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

¹⁶⁸ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 38.3, Akses në EduPage IV.5.3", ASCAL, Dok. nr.100. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁶⁹ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 9, Rregullore e Sekretarisë Mësimore", ASCAL, Dok. nr.22. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁷⁰ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 38, Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit", ASCAL, Dok. nr.98. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁷¹ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 38.2, Shembuj nga EduPage-Stafi", ASCAL, Dok. nr.99. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁷² Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 39, Të dhënat nga faqja zyrtare e WEB (Për kriteret përkatëse)", ASCAL, Dok. Nr.104. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 40, Politikat Institucionale të Publikimit të Informacionit", ASCAL, Dok. nr.105. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i raportit vjetor të institucionit dhe pasqyrave financiare, bashkëlidhur kërtyj raporti, konstatohet se çdo vit institucioni paraqet të dhënat financiare në raport. Ato pasqyrojnë kostot e shpenzuara, të ardhurat dhe përcaktimin e tarifës së shkollimit, si dhe kosto financiare, mesatare për student, si dhe vihet re se aty trajtohet dhe ecuria e programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor¹⁷³. Po ashtu vihet re se institucioni i siguron të ardhurat nga buxheti i Fondacionit “Logos” dhe nga tarifat e studentëve, ku evidentohet se është një institucion i vogël, që i mbulon shpenzimet e programit të studimit Bachelor në Mësuesi “Arsima Parashkollor”.¹⁷⁴</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grandet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të</p>	<p>Rezultojnë se Institucioni ka një Plan të financimit¹⁷⁵, të hartuar në nivel institucional. Ai paraqet në mënyrë të detajuar të ardhurat financiare, të cilat shërbejnë për financimin në total të burimeve njerëzore të institucionit për çdo program studimi, ku përfshihet dhe programi Mësuesi në “Arsim Parashkollor”. Gjithashtu plani prezanton dhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpenzimet për shërbimet operative për mirëmbajtjen; • shpenzimet për studime e bursa; • shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor; • shpenzimet për bibliotekën dhe detyrime të tjera, financiare;

¹⁷³ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 29.3, Raporti Vjetor 2018-2019, Kolegji Universitar LOGOS”, ASCAL, Dok. nr.47. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁷⁴ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 56.8, Njoftimi i dorëzimit të Bilancit”, ASCAL, Dok. Nr.169. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 56.9, Realizimi i Buxhetit 2018-2019-2020”, ASCAL, Dok. Nr.170. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 56.10, Realizimi i Buxhetit 2018-2019-2020_Personeli”, ASCAL, Dok. Nr.171. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 56.11, Realizimi i Buxhetit 2018-2019-2020_Studentët”, ASCAL, Dok. Nr.172. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 56.12, Projekt Buxheti 2020-2024”, ASCAL, Dok. nr.173. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁷⁵ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, “Aneksi 56.12, Projekt Buxheti 2020-2024”, ASCAL, Dok. nr.173. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.				
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Konstatohet se, nga shqyrtimi i Raportimit Financiar për vitin 2020, institucioni mbledh të dhëna nga njësitë bazë ¹⁷⁶ që shërbejnë për hartimin dhe miratimin e projekt-buxhetit. Çdo vit institucioni kryen auditim dhe vlerëson gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar. Evidentohet se Raportimi Financiar realizohet në nivel intitucional, në mënyrë periodike, sepse pasqyra e hollësishme, financiare në Raportin e Auditimit 2019 paraqet të ardhurat nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, si dhe ndarjen e burimeve financiare ¹⁷⁷ . Ndërkohë në planin e projekt-buxhetit 2020-2024 janë shënuar të dhëna financiare që tregojnë se institucioni do të ketë vijimësi financiare.			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Konstatohet se, në raportet financiare të tre viteve të fundit, institucioni analizon shpenzimet e buxhetit sipas zërave të planifikuara në buxhetin afatmesëm 3-vjeçar, bën krahasime midis tyre, në mënyrë që të ketë qëndrueshmëri dhe vijimësi financiare. Evidentohet në raportin vjetor të Institucionit se, në analizën vjetore të tij, zë vend të veçantë realizimi ose jo i zërave financiarë, dokument i cili i dërgohet te Bordi i Administrimit dhe ai Drejtues i institucionit.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Refetruar RVB rezulton se, sipas Raportit Financiar, ¹⁷⁸ në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare jo vetëm të një viti akademik, por bën një analizë krahasuese të zërave të buxhetit ndër vite dhe planifikon ndërhyrjet e duhura të financimit, për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

176. Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 56.12, Projekt Buxheti 2020-2024", ASCAL, Dok. nr.173. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

177 Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 41, Raportimi financiar 2020 dhe miratimi i Projekt-Buxhetit 2020", ASCAL, Dok. nr.106. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

178 Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 41, Raportimi financiar 2020 dhe miratimi i Projekt-Buxhetit 2020", ASCAL, Dok. nr.106. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatorë.	Konstatohet se institucioni respekton procedurat ligjore për kriteret e pranimit dhe transferimit, të cilat bazohen në ligjin e arsimit të lartë, si dhe te aktet nënligjore, përkatëse që MAS nxjerr çdo vit për aplikimet dhe regjistrimet në programin e ciklit bachelor. Gjithashtu institucioni bazohet tek propozimet e bëra nga njësitë bazë dhe të miratura nga Senati Akademik për kuotat ¹⁷⁹ dhe kriteret. ^{180/181} .
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Konstatohet se institucioni çdo vit akademik përpara fillimit të tij, në afatet e duhura, me propozim nga Departamenti dhe me miratim nga Senati dhe MARS ¹⁸² , harton kritere dhe procedura që respektojnë dhe sigurojnë shanse të barabarta për të gjithë kandidatët e interesuar, ku përfshihen ata të trojevve, të pakicave kombëtare dhe maturantët me aftësi të kufizuara. ¹⁸³ , etj.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë	Rezulton se institucioni ¹⁸⁴ miraton dhe publikon çdo vit kriteret e pranimit në programet e studimit, si dhe kritere të vlerësimit të kompetencave të studentëve dhe ato të diplomimit të tyre, të cilat evidentohen në Rregulloren e Programit të Studimit ¹⁸⁵ , të Statuti ¹⁸⁶ dhe Rregullorja e Institucionit.

¹⁷⁹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 5, Rregullore e Përgjithshme e KU "LOGOS", ASCAL, Dok. nr.17. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁸⁰ Kolegji Universitar "Logos", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 2, Statuti i KU "Logos", ASCAL, Dok. nr.13. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁸¹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimit "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁸³ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 5, Rregullore e Përgjithshme e KU "LOGOS", ASCAL, Dok. nr.17. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁸⁴ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 43, Politikat e marketingut të programit të studimit _Format e tij _Transparenca me Publikun", ASCAL, Dok. nr.108. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁸⁵ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimit "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁸⁶ Kolegji Universitar "Logos", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 2, Statuti i KU "Logos", ASCAL, Dok. nr.13. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.				
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Institucioni paraqet çdo vit akademik kritere dhe kuota të pranimit në Kolegj, të cilat respektojnë kriteret e VKM-ve përkatëse për notën mesatare. Ato vendosen në faqen zyrtare të tij, por dhe në portalin e maturantëve. Departamenti që mbulon këtë program propozon kritere dhe kuota, kurse senati i miraton ato.			
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Nga shqyrtimi i Rregullores së Programit të studimit rezultojnë kriteret dhe kuotat e pranimit janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore. Në kuotat e propozuara për vitet akademike 2018-2019, 2019-2020 për këtë program studimi, institucioni ka propozuar kuota si për kandidatët nga trojet dhe për studentët e huaj. ¹⁸⁷			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Evidentohet se Institucioni ka organizuar me shkollat e mesme të bashkive të ndryshme takime informuese rreth programeve të studimit që ofron. Takimet më pas kanë qenë kryesisht online (për shkak të situatës Covid-19), por informim është kryer dhe në panairt që organizon MASR ¹⁸⁸ , si dhe me anë të komunikimit në rrjetet sociale dhe në formate të tjera, online ¹⁸⁹ . Në format e mësipërme të komunikimit me kandidatët për studentë prezantohen kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, dokumentacioni i regjistrimit, si dhe vlefshmëria e programit për tregun e punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me	Konstatohet se institucioni vë në dispozicion të studentit informacione të detajura lidhur me kriteret dhe progresin e studentëve nga një vit në vitin tjetër akademik. Kjo evidentohet

¹⁸⁷ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 31.8, Statistika mbi studentët e huaj në LOGOS 2017-2020", ASCAL, Dok. nr.57. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁸⁸ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 31.4, Aktivitetet për vitet akademike 2017-2020", ASCAL, Dok. nr.53. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁸⁹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 43, Politikat e marketingut të programit të studimit _Format e tij _Transparenca me Publikun", ASCAL, Dok. nr.108. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>në dokumente të tilla si: Rregullorja e Programit të Studimit¹⁹⁰, Programet lëndore¹⁹¹, Datat e provimeve dhe sezonet e mbartuara dhe diplomimi¹⁹², Faqja e internetit http://kuloskos.edu.al/en/arsimpar.html dhe fletëpalosja për studentët¹⁹³. Ato mundësojnë që studentët të qartësohen për kriteret e vlerësimit, prapen e kalueshmërisë dhe modalitetet e diplomimit.</p> <p><i>Rekomandohet që institucioni të afishojë në këndet përkatëse të fakultetit, pranë departamenteve, në mjedise publike, informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Evidentohen kriteret dhe procedura të qarta për të njohur lëndë/module nga kualifikimet e mëparshme për studentët që shprehen qartë në dokumentet zyrtare të këtij programi studimi, si: Rregullorja e Programit të Studimit¹⁹⁴ dhe Rregullorja e Departamentit.¹⁹⁵</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i evidencave, si: Plani mësimor dhe programet lëndore, konstatohet se çdo program lëndor paraqet qartë kriteret dhe procedurat e vlerësimit të njohurive dhe aftësive të studentëve¹⁹⁶. Po ashtu parimet të vlerësimit për këtë program studimi gjenden dhe te Rregullorja e Programit të studimit¹⁹⁷.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Evidentohet se janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe te diplomimit në programin e studimit në Rregulloren e Programit të Studimit¹⁹⁸. Sipas saj, studentët përfundojnë ciklin e studimeve të tyre Bachelor me temë diplome, kur janë me mesatare mbi 7.5 ose provim formimi, për të cilin hartohet fondi i pyetjeve që miratohet nga Departamenti që mbulon programin. Fondi u vohet në dispozicion studentëve në</p>

¹⁹⁰ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimit "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁹¹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 16.1, Syllabuset e lëndëve 2018-2019", ASCAL, Dok. Nr.30. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 16.2, "Syllabuset e lëndëve 2019-2020", ASCAL, Dok. Nr.31. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 16.3, "Syllabuset BA-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.32. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁹² Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 46.8, Vendim SA nr.3, datë 15.11.2020_Miratimi i Kalendarit Akademik 2020 -2021", ASCAL, Dok. nr.123. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁹³ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 43.1, Materialet dhe Broshurat Informuese për studentin", ASCAL, Dok. nr.109. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁹⁴ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimit "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁹⁵ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6.1, Draft-Rregullore e DPP-së ", ASCAL, Dok. Nr.19. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>;

¹⁹⁶ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 16.3, "Syllabuset BA-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.32. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁹⁷ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimit "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁹⁸ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 7, neni 18. Rregullore e Programit të Studimit "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	fillim të vitit akademik, por gjithnjë jo më vonë se në fillim të semestrit të dytë të vitit të tretë akademik. ¹⁹⁹			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Konstatohet se Institucioni zhvillon me shkollat e mesme në vend takime informuese rreth institucionit dhe programeve të studimit që ai ofron ²⁰⁰ . Gjithashtu institucioni ka prezencë të tij në ditët e hapura për maturantët që përcakton MAS. Kjo u evidentua nga takimi fizik me studentët (njëkohësisht dhe online), ku u theksua se edhe Departamenti zhvillon takime online (gjatë pandemisë) ku i informon studentët e rinj për programin e studimit ²⁰¹ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Nga shqyrtimi i Statutit ²⁰² , i Rregullores së Fakultetit ²⁰³ dhe programit, i Rregullores për provimet online ²⁰⁴ , si dhe nga komunikimi me sekretarinë ²⁰⁵ mësimore dhe me koordinatorin e programit konstatohet se institucioni mundëson që studentët të marrin informacionet e duhura dhe të hollësishme për programin e studimit.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe	Rezulton se studentët kanë mundësi të informohen në faqen institucionale të internetit lidhur me programin dhe detajet e kërkesat e tij, por dhe nëpërmjet udhëzuesit dhe informacioneve të printuara të programit në nivel fakultetit ²⁰⁶ .

¹⁹⁹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 10, Rregullore e Diplomimit", ASCAL, Dok. nr.23. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰⁰ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 31.4, fq 50-52 Aktivitetet për vitet akademike 2017-2020", ASCAL, Dok. nr.53. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰¹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 31.4, fq 6.Aktivitetet për vitet akademike 2017-2020", ASCAL, Dok. nr.53. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰² Kolegji Universitar "Logos", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 2, Statuti i KU "Logos", ASCAL, Dok. nr.13. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰³ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor", ASCAL, Dok. nr.18. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰⁴ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 54.2, Orari i Provimeve dhe angazhimi i stafit", ASCAL, Dok. Nr.155. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 54.6, Rregullore për provimet on-line 2020", ASCAL, Dok. nr.159. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰⁵ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 9, Rregullore e Sekretarisë Mësimore", ASCAL, Dok. nr.22. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰⁶ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor", ASCAL, Dok. Nr.18. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6.1, Draft-Rregullore e DPP-së", ASCAL, Dok. Nr.19. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 7,

dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.									
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Rezulton se studentët informohen mbi mundësitë e punësimit dhe tregun e punës. ²⁰⁷ Kjo u evidentua në takimin fizik dhe njëkohësisht online me ta, por dhe në takimin me koordinatorin e marrëdhënieve me studentët. Nga takimi që GVJ pati me Zyrën e Këshillimit të Studentëve dhe Alumni, u informua që kjo zyrë orienton studentët drejt tregut të punës. Çdo student që merr pjesë në aktivitete të zhvillimit të karrierës duhet të regjistrohet pranë zyrës përkatëse duke ndjekur hapat e përshkruar në Rregulloren mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës (Aneksi 12).								
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Referuar RVB dhe takimeve në Institucion evidentohet se, në fillim të çdo viti akademik, Departamenti që mbulon programin e studimit, organizon një takim fizik informues me studentët e vitit të parë, të cilët lehtësohen lidhur me përshtatjen e tyre në mjediset fizike të institucionit, me shërbimet dhe zyrat mbështetëse për ta, si: auditorë, sekretari, bibliotekë dhe oraret e studimit në të, por dhe njihen me sistemin elektronik të komunikimit. Gjatë situatës së pandemisë kjo procedurë kryejë online si dhe me materiale informuese për programin e studimit ²⁰⁸ , të cilat publikohen online ose broshura të printuara.								
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Nga takimi i drejtpërdrejtë i GVJ me studentët (dhe me ata online) rezulton, se Platformat 'MS TEAMS' dhe 'EduPage', që dispononte institucioni, u mundësojnë atyre të marrin informacione në çdo kohë dhe kudo që janë. Po ashtu studentët kanë mundësi që të ndërveprojnë online me platformat edhe gjatë realizimit të procesit mësimor, por dhe të marrin informacionet përkatëse lidhur me rezultatet e tyre në provime, me programin e studimitit, etj elemente të nevojshme për ta. ²⁰⁹								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Rregullore e Programit të Studimit "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰⁷ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 12, Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve studentore dhe këshillimit të karrierës", ASCAL, Dok. nr.25. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰⁸ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 31.5, Klubet studentore dhe veprimtaria e tyre", ASCAL, Dok. Nr.55. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 31.7, Karta e studentit", ASCAL, Dok. nr.56. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰⁹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 38.1, Shembuj nga EduPage-studentët", ASCAL, Dok. nr.98. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>GVJ vizitoi sekretarinë mësimore ku mbahen rregjistrat në lidhje me rregjistrimin, ecurinë akademike dhe diplomimin e studentëve. GVJ kontrolloi rregjistrin themeltar të studentëve të rregjistruar dhe të transferuar si dhe rregjistrin e arritjeve akademike me lëndë të zgjedhura rastësisht dhe nuk vërejti gabime apo problematika. Të dhëna statistikore për numrin e studentëve të programit jepen edhe në Raportin Vjetor të Institucionit dhe të njësisë bazë.²¹⁰</p> <p>Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vitet akademike është:</p> <p>Viti Akademik 2018-2019 9 studentë – 4 të regjistruar; Viti Akademik 2019-2020 3 studentë; Viti Akademik 2020-2021 6 studentë;</p> <p>Totali për një cikël studimi 14 studentë gjithsej.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni disponon statistika për numrin e të regjistruarve, tërheqjeve nga programi, largimeve etj. Sekretaria mësimore është zyra, e cila kryen gjithë procedurat e regjistrimit, të transferimit, të largimit deri në diplomimin e studentëve në këtë program studimi, gjë që është e sanksionuar në Rregulloren e fakultetit (njësisë qendrore)²¹¹ Gjithashtu është po sekretaria që harton dhe ruan statistika vjetore me të dhëna të plota dhe të detajuara për studentët²¹².</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ konfirmoi që sekretaria rregjistron informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit deri në diplomimin e tyre. Informacioni hidhet online dhe është i aksesueshëm nga studentët nëpërmjet sistemit kompjuterik/online, të</p>

²¹⁰ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.3, Raporti Vjetor 2018-2019, Kolegji Universitar LOGOS", ASCAL, Dok. Nr.47. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.4, Raporti Vjetor 2019-2020, Kolegji Universitar LOGOS", ASCAL, Dok. nr.48. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²¹¹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 6, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor", ASCAL, Dok. Nr.18. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²¹² Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 22, Tabela Nr.21, Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve", ASCAL, Dok. nr.38. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	cilat evidentojnë procesin e studimeve dhe arttjet e studentëve, dokumentaicon i plotësuar sipas legjislacionit në fuqi. ²¹³ .			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Të dhënat paraqesin regjistrimet, largimet, transferimet, rezultatet në provimet semestrale për çdo lëndë e student, numrin e krediteve, studentët e diplomuar dhe temën përkatëse të tezës së diplomës. ²¹⁴			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në fund të çdo viti akademik, institucioni bën një analizë mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje të cilin e përfshin në Raportin Vjetor ²¹⁵ . Nga shqyrtimi i tyre evidentohen të dhëna për studentët e programit bachelor të arsimit parashkollor. Nga ana tjetër në takimin me sekretarinë mësimore identifikohen të dhëna të detajuara për numrin e studentëve të regjistruar, për largimet nga programi, për largimet para përfundimit të programit, por me rëndësi janë të dhënat për notën mesatare hyrëse dhe dalje.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve	Dokumentat zyrtare, të Institucionit si Rregullore e institucionit, Statuti i tij ²¹⁶ , parashikojnë përfshirjen e studentëve në hallkat vendimmarrëse dhe këshilluese, në plotësim të kërkesave të Ligjit

²¹³ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 31.12, Korrespondencë me QSHA për pajisjen me NIM", ASCAL, Dok. Nr.61. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 31.13, Rregjistri i notave MAP", ASCAL, Dok. Nr.62. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 31.14, MAP- Regjistër elektronik", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²¹⁴ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 9, Rregullore e Sekretarisë Mësimore", ASCAL, Dok. nr.22. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²¹⁵ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.1, Raporte vjetore të DPP-së", ASCAL, Dok. Nr.45. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.2, Raport Vjetor i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor 2018-2019", ASCAL, Dok. nr.46. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²¹⁶ Kolegji Universitar "Logos", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 2, Statuti i KU "Logos", ASCAL, Dok. Nr.13. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 31.9, Statuti i Këshillit Studentor", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 31.10, Rregullore e Këshillit Studentor", ASCAL, Dok. nr.59. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".²¹⁷ Studentët kanë të drejtë të kenë përfaqësues në Senatin Akademik me dy anëtarë/studentë, duke respektuar kuotat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, por përfaqësues studentor dhe në Këshillin e Etikës.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Sipas statutit studentët janë pjesë e vendimmarrjes në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që IAL është angazhuar maksimalisht në orientimin e studentëve në lidhje me të drejtat e tyre dhe përfaqësimin e tyre në hallkat e institucionit, për të sjellë shqetësimet dhe zgjidhjet e tyre. Përfshirja e studentëve në vlerësimin e procesit akademik nëpërmjet pyetësorëve që plotësojnë; është një proces i cili kryhet në mënyrë të pavarur nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe është një instrument që ka ndihmuar në përmirësimin e programeve dhe adresimin më të mirë të nevojave të studentëve. Në Grupin e punës ngritur nga NJSBC për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm(RVB) për këtë program studimi, është përfshirë një përfaqësues i qeverisë studentore, student i këtij programi. Po ashtu evidentohet në dokumente përfshirja e studentëve në senatin akademik²¹⁸, si dhe mundësitë që studentët kanë për të të shprehur mendime të lira nëpërmjet instrumenteve që vlerësojnë cilësinë e shërbimit arsimor që ofron stafi dhe institucioni në tërësi.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave burokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të programit, por dhe i ngarkesës totale, mësimore të stafit me kohë të plotë dhe të pjesshme rezultojnë se dokumentacioni zyrtar i kurrikulës së programit të studimit, respektojnë aktet ligjore në fuqi, duke iu përmbajtur ngarkesës mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, duke realizuar faktike jo më shumë se 20 orë mësimore në javë²¹⁹. Nga ana tjetër, duke llogaritur numrin e orëve që kryen një student në këtë program, rezultojnë se sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh nga një student me kohë të plotë, është 60 kredite ose 1500 orë mësimore punë të studentit për çdo vit akademik. Gjatë vitit të parë studentët zhvillojnë 600 orë në auditor dhe 815 orë punë të pavarur; gjatë vitit të dytë studentët zhvillojnë 585 orë në auditor dhe 870 orë punë të pavarur dhe gjatë vitit të</p>

²¹⁷ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 5, Rregullore e Përgjithshme e KU "LOGOS", ASCAL, Dok. nr.17. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²¹⁸ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 46.7, Vendim SA nr.23, dt 30.10.2020_Mbi përbërjen e Senatit Akademik", ASCAL, Dok. nr.122. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²¹⁹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 13, Dosja e plotë e Programit të Studimit me elementët përbërës të tij", ASCAL, Dok. nr.26. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	dytë studentët zhvillojë 577 orë në auditor dhe 888 orë punë të pavarur.			
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Evidentohet se Departamenti ka të dokumentuar ndryshimet kurrikulare që lidhen me përmirësimin e programeve ²²⁰ të studimit, në të cilat kanë dhënë kontribut dhe studentët, gjë që rezulton në dokumente zyrtare si: Statuti dhe Rregullorja e institucionit, por dhe në raportimet departamentale. Përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendimarrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Si një mënyrë e drejtpërdrejtë në këtë drejtim shërben pyetëtori që plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri.			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Konstatohet se të dhënat e mbledhura nga plotësimi i pyetësorit të studentëve paraqesin idetë dhe mendimet e tyre për cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor (leksione+ seminare) por dhe për kompetencën profesionale të pedagogëve ²²¹ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Rezulton se institucioni përdor procedura për informimin e studentëve nëpërmjet zyrave përkatëse, p.sh. sekretaria mësimore. Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, bashkëpunon me Njësinë Kryesore dhe atë bazë informojnë studentët në mënyrë të vazhdueshme. Koordinator i departamentit asiston

²²⁰ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 44, Procedurat për Ndryshimin e Kurrikulës", ASCAL, Dok. nr.111. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²²¹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.6, Vlerësimi i performancës së stafit, pyetësor, SEM I, 2019-2020", ASCAL, Dok. Nr.132. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.7, Raport nga NJSBC për rezultatet 22.07.2019", ASCAL, Dok. nr.133. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	studentët ²²² dhe kryen verifikimet e domosdoshme për detyrimet që studentit duhet të shlyejë.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Referuar RVB konstatohet se nëpërmjet faqes zyrtare, online të institucionit, studentët kanë mundësi të informohen edhe në distancë për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave online, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim. Gjithashtu informacione më të detajuara për profilin e tyre personal, studentët mund të gjejnë në platformat Edupage & MS TEAMS, ku mund të informohen për provimet, vlerësimet e vazhduara dhe vlerësimet përfundimtare ²²³ .
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Konstatohet se Zyra e Këshillimit të Karrierës ofron informacion dhe mbështetje për kandidatët për studentë, për studentët dhe Alumni lidhur me planifikimin e karrierës së tyre nëpërmjet formave të shumëllojshme të komunikimit ²²⁴ , por jepet dhe mbështetje me bursa të ndryshme për ta ²²⁵ . Praktikrat profesionale zhvillohen në institucione private dhe shtetërore, sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga Departamenti ²²⁶ , por situata e pandemisë e ka kushëtzuar këtë proces, i cili është zhvilluar dhe online.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Nga takimi me Zyrën e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, u konstatua se disponojnë të dhëna statistikore mbi punësimin e të diplomuarve. Nga takimi me grupin e studentëve rezultoi se 3 prej tyre ishin të punësuar si mësuese kopshti, por duke qenë se priten diplomimet e para, pas akreditimit, nuk kishin të dhëna të plota për punësimin e studentëve pas diplomimit.

²²² Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 5, Rregullore e Përgjithshme e KU "LOGOS", nenet 130-131, ASCAL, Dok. nr.17. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²²³ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 38.3, Akses në EduPage IV.5.3", ASCAL, Dok. nr.100. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²²⁴ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 12, Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve studentore dhe këshillimit të karrierës", ASCAL, Dok. nr.25. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²²⁵ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 43, Politikrat e marketingut të programit të studimit Format e tij Transparenca me Publikun", ASCAL, Dok. Nr.108. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 43.1, Materialet dhe Broshurat Informuese për studentin", ASCAL, Dok. nr.109. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²²⁶ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 45, Praktikrat profesionale", ASCAL, Dok. nr.112. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatorë institucionale.	Referuar RVB dhe takimeve në institucion, GVJ konstaton se KU "Logos" ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe vlerësimin Institucional, të cilat janë përgjegjëse për monitorimin e cilësisë. Senati Akademik në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015, ka miratuar Komisionin e Përherëshëm për Vlerësimin Instiucional, i cili harton politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me standartet shtetërore të cilësisë. E gjithë veprimtaria e sigurimit të Cilësisë parashikhet në Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë. ²²⁷
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	GVJ konstaton se institucioni ka funksionale Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ²²⁸ që nga viti i themelimit të tij, si dhe është ngritur Komisioni i Përherëshëm i Sigurimit të Cilësisë dhe është hartuar Rregullorja e tij. <i>Rekomandohet hartimi i një plani strategjik për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së institucionit, ku të përfshihen gjithashtu studentët dhe bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm.</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e	NJSBC përdor disa instrumenta për vlerësimin periodik të mësimdhënies, mësimnxënies, veprimtarive kërkimore dhe shërbimeve për mbështetjen e studentëve si: vlerësimet për

²²⁷ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 8, Rregullore për Sigurimin e Cilësisë", ASCAL, Dok. Nr.21. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 32, Pyetësor i studentëve", ASCAL, Dok. Nr.64. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 33, Pyetësor i Stafit akademik dhe ndihmës.

²²⁸ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47, Rregullore e Komisionit të Garantimit të Standardeve të Cilësisë së Institucionit", ASCAL, Dok. Nr.126. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.1, Politikat për Sigurimin e Cilësisë", ASCAL, Dok. Nr.127. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.4, Vendime mbi përbërjen e NJSBC-së (2011-2018-2020 të KU-LOGOS)", ASCAL, Dok. nr.130. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>performancën e stafit akademik²²⁹, dhe pyetësi i studentëve për matjen e cilësisë së mësimdhënies²³⁰. Të dhënat grumbullohen, përpunohen nga NJSBC dhe bëhen pjesë e raportit vjetor të institucionit. Programi i Studimit Bsc në "Mësuesi për arsimin parashkollor" është në proces akreditimi për here të parë. GVJ konstatoi që IAL përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë dhe ky proces realizohet me përfshirjen e të gjitha strukturave.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në nivel institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i projekt-strategjisë (2020-2023)²³¹ të institucionit, i raportit vjetor të institucionit²³² dhe njësisë bazë²³³, por dhe i strategjisë²³⁴ së kërkimit shkencor rezulton se Institucioni zbaton politika dhe procedura të vijueshme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programi të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin,</p>	<p>Konstatojmë se institucioni ka ngritur në nivel njësie bazë grupin e punës për rritjen e cilësisë²³⁵ GVJ referuar takimeve në institucion</p>

²²⁹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 32, Pyetësori i studentëve", ASCAL, Dok. Nr.64. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 33, Pyetësori i Stafit akademik dhe ndihmës.

²³⁰ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.6, Vlerësimi i performancës së stafit, pyetësori, SEM I, 2019-2020", ASCAL, Dok. Nr.132. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.7, Raport nga NJSBC për rezultatet 22.07.2019", ASCAL, Dok. nr.133. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²³¹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 4, Plani Strategjik i Zhvillimit të FSHHKGJGJ", ASCAL, Dok. nr.15. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²³² Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.3, Raporti Vjetor 2018-2019, Kolegji Universitar LOGOS", ASCAL, Dok. nr.47. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²³³ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.1, Raporte vjetore të DPP-së", ASCAL, Dok. nr.45. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²³⁴ Kolegji Universitar "Logos", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 3, Plani Strategjik i Zhvillimit të KU "Logos" ", ASCAL, Dok. nr.14. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²³⁵ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 4.1, Draft Plani Strategjik i Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë ", ASCAL, Dok. nr.16. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	konstaton se NJSBC monitoron, rishikon dhe kontrollon ecurinë e programit të studimit. Pjesë e këtij procesi janë pyetsorët e realizuar nga njësia për stafin akademik dhe studentët, ku rezultatet e këtij procesi i komunikohen autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Rezultoni se hartohet çdo vit akademik Raporti Vjetor ²³⁶ në rang institucioni dhe të Plani Strategjik ²³⁷ i Departamentit paraqitet një analizë për përdorimin e mekanizmave për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit bachelor.
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	U konstatua nga GVJ se institucioni ²³⁸ ka të miratuara dhe përdor instrumente vlerësimi që masin cilësinë e zbatimit të programit të studimit, si pyetësor, anketim, të cilat plotësohen “ballë për ballë” dhe “online” me studentët ose nga pedagogët. Të dhënat pasqyrohen në raportet vjetore të departamentit dhe të institucionit.
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Nëpërmjet instrumenteve matëse për vlerësimin e stafit dhe pyetësor për studentët, studentëve u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës. Pas shqyrtimit të procedurës për analizën e vlerësimit të pyetësorit të studentëve rezultoni se të dhënat e rezultateve u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit ²³⁹
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Institucioni harton çdo vit Raportin Vjetor dhe në të trajtohen rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë ²⁴⁰ .

²³⁶Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.1, Raporte vjetore të DPP-së", ASCAL, Dok. Nr.45. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.2, Raport Vjetor i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor 2018-2019", ASCAL, Dok. Nr.46. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.3, Raporti Vjetor 2018-2019, Kolegji Universitar LOGOS", ASCAL, Dok. nr.47. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²³⁷ Kolegji Universitar “Logos”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 3, Plani Strategjik i Zhvillimit të KU “Logos” ", ASCAL, Dok. nr.14. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²³⁸ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.7, Raport nga NJSBC për rezultatet _22.07.2019", ASCAL, Dok. nr.133. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²³⁹ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.5, NJSBS _Rezultatet e pyetësorëve", ASCAL, Dok. Nr.131. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.6, Vlerësimi i performancës së stafit, pyetësor, SEM I, 2019-2020", ASCAL, Dok. Nr.132. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.7, Raport nga NJSBC për rezultatet _22.07.2019", ASCAL, Dok. nr.133. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁴⁰ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 35.11, Seminar Zhvillimi për Personelin Akademik", ASCAL, Dok. nr.93. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3 Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Nga shqyrtimi i RVB rezulton se, në mënyrë të vijueshme, vit pas viti, hartohet Raportin Vjetor i Institucionit ku pasqyrohen objektivat dhe synimet për departamentin, studentët ²⁴¹ dhe kërkimin shkencor ²⁴² . NJSBC kryen vlerësime të brendshme të programit të studimit në mënyrë periodike, monitoron rregullisht realizimin e programit të studimit dhe rezultatet e studentëve të arritura në procesin mësimor, ndjek studentin gjatë praktikës profesionale dhe gjatë përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Konstatohet se për procesin e vlerësimit të brendshëm janë shqyrtuar dokumente zyrtare të institucionit, si raporti vjetor institucional ²⁴³ , të dhënat e nxjerra nga pyetësi me studentët ²⁴⁴ , raporti vjetor i departamentit ²⁴⁵ , si dhe Strategjia e zhvillimit të fakultetit.
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor	GVJ konstatoi se përdoren metoda të ndryshme ²⁴⁶ , efektive në formatet “ballë për ballë” dhe “online”, të cilat synojnë ²⁴⁷ të mbledhin të dhëna, t’i përpunojnë dhe t’i shqyrtojnë ato. Ato sigurojnë informacione që mundësojnë krahasime për procese të

²⁴¹ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.7, Raport nga NJSBC për rezultatet 22.07.2019", ASCAL, Dok. nr.133. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁴² Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.1, Raporte vjetore të DPP-së", ASCAL, Dok. Nr.45. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.4, Raporti Vjetor 2019-2020, Kolegji Universitar LOGOS", ASCAL, Dok. nr.48. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁴³ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.3, Raporti Vjetor 2018-2019, Kolegji Universitar LOGOS", ASCAL, Dok. nr.47. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁴⁴ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 32, Pyetësori i studentëve", ASCAL, Dok. Nr.64. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 33, Pyetësori i Stafit akademik dhe ndihmës.

²⁴⁵ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 29.4, Raporti Vjetor 2019-2020, Kolegji Universitar LOGOS", ASCAL, Dok. nr.48. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁴⁶ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 32, Pyetësori i studentëve", ASCAL, Dok. Nr.64. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 33, Pyetësori i Stafit akademik dhe ndihmës akademik", ASCAL, Dok. nr.65. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁴⁷ Kolegji Universitar “LOGOS”, FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 30, Raporte Vjetore të monitorimit dhe Sigurimit të Cilësisë", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>vlerësimin të punës së pedagogëve, për vlerësimin e mësimdhënies, për përmirësimin e kurrikulës, por dhe shërbejnë për përmirësime të formave dhe metodave të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimin të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni realizonte në mënyrë periodike dy pyetësorë²⁴⁸, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për matjen e performancës së stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi; - Për cilësinë e mësimdhënies; <p><i>Rekomandohet që institucioni të zhvillojë sondazhe ose/dhe intervista të personelit akademik e ndihmës akademik si dhe bashkëpunëtorëve të tjerë që kontribuojnë në realizimin e këtij program studim apo/dhe që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>

²⁴⁸ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 32, Pyetësor i studentëve", ASCAL, Dok. Nr.64. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq> Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 33, Pyetësor i Stafit akademik dhe ndihmës akademik", ASCAL, Dok. nr.65. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Evidentohet se institucioni ka të miratuara dokumente zyrtare, të tilla si: Rregullore e Sigurimit të Cilësisë²⁴⁹, të shoqëruara me instrumente të vetëvlerësimit, të cilat orientojnë zbatimin në institucion të politikave të sigurimit të cilësisë. Ato janë në mbështetje dhe të dokumenteve themelore, institucionale, si: Statuti dhe Rregullore Fakulteti. Dokumentet e mësipërme orientojnë dhe paraqesin detyra dhe përgjegjësi të përfshirjes në procese të vetëvlerësimit të njësisë bazë, të personelit dhe për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Institucioni dëshmon kulturë pune për çështje të sigurimit të cilësisë, sepse ai përdor intruktive profesionale si dhe delegon detyra konkrete për zbatim nga organizmat e brendshme të saj (njësi qendrore dhe njësi bazë), por dhe për studentët²⁵⁰ dhe pedagogët që përfshihen në procese të vetëvlerësimit. Departamenti ndjek gjithashtu procedurën dhe matjet e veta, të cilat i shtohen Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet se ngritja e ekipit të vetëvlerësimit²⁵¹, përfshirja e stafit akademik dhe mbështetës janë pjesë e kulturës së punës institucionale (njësi bazë dhe njësi qendrore) lidhur me sigurimin e cilësisë qoftë në rrafshin institucional, por dhe në atë të zbatimit të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj</p>	<p>Institucioni deklaron në dokumentet zyrtare²⁵² qëndrime etike²⁵³ lidhur me integritetin akademik, por dhe për kujdesin dhe respektimin e të drejtave²⁵⁴ dhe barazisë për stafin akademik dhe atë mbështetës. Departamenti është i hapur në procesin e vlerësimit të brendshëm duke përfituar nga mendimet e studentëve si dhe personelit akademik dhe atij administrativ. Në pyetsorët e studentëve</p>

²⁴⁹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47, Rregullore e Komisionit të Garantimit të Standardeve të Cilësisë së Institucionit", ASCAL, Dok. Nr.126. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.1, Politikat për Sigurimin e Cilësisë", ASCAL, Dok. Nr.127. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.4, Vendime mbi përbërjen e NJSBC-së (2011-2018-2020 të KU-LOGOS)", ASCAL, Dok. nr.130. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁵⁰ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.4, Vendime mbi përbërjen e NJSBC-së (2011-2018-2020 të KU-LOGOS)", ASCAL, Dok. nr.130. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁵¹ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 47.4, Vendime mbi përbërjen e NJSBC-së (2011-2018-2020 të KU-LOGOS)", ASCAL, Dok. nr.130. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁵² Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 5, Rregullore e Përgjithshme e KU "LOGOS", ASCAL, Dok. nr.17. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁵³ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 49.1, Kodi i Etikës", ASCAL, Dok. nr.137. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁵⁴ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 63, Zbulimi i Plagjiaturës në një detyrë", ASCAL, Dok. nr.199. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	respektohet anonimati dhe cdo anëtar i stafit ka të drejtë të shprehë publikisht mendimin e vet për çështje që kanë të bëjnë me ecurinë e programit të studimit, si në raportet e tyre ashtu edhe në mbledhjet e Departamentit, që janë organi kryesor i vendimmarrjes.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Evidentohet se institucioni disponon marrëveshje bashkëpunimi ²⁵⁵ me universitete analoge në Greqi, si: Universiteti i i Preut, i Trakës dhe ai i Selanikut, të cilat kanë mundësuar dhe shkëmbimin e pedagogëve midis tyre në procese mësimore të dyanshme, të cilat ndikojnë dhe në rritjen e cilësisë së shërbimit arsimor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Nga vëzhgimi i faqes së internetit të Kolegjit evidentohet në të paraqitja e dokumenteve zyrtare që lidhen me sigurimin e cilësisë, si Rregullore e Sigurimit të Cilësisë, statuti i institucionit, dokumente të tjera institucionale, si dhe organizmat e qeverisjes së institucionit, etj.
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga vëzhgimi i faqes së internetit të institucionit rezulton se aty vendosen dokumente zyrtare, institucionale, por dhe raporte që paraqesin arritje rezultate dhe vlerësime të programeve të studimit.

²⁵⁵ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 27, Marrëveshjet e bashkëpunimit", ASCAL, Dok. nr.43. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>; Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 28, Korrespondenca të KU-LOGOS në kuadër të zgjerimit të rrjetit të bashkëpunëtorëve", ASCAL, Dok. nr.44. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Evidentohet se janë të identifikuara nevojat për përmirësim, si dhe është hartuar një Plan i Zhvillimit Institucional, i cili mbulon probleme dhe çështje që lidhen me fakultetin që mbulon programin bachelor në arsimin parashkollor ²⁵⁶ .			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni ka të përgatitur Draft-strategjinë e Zhvillimit ²⁵⁷ në nivel fakulteti, dokument që ka të identifikuara nevojat për përmirësim që lidhen me veprimtrainë kërkimore, për studentët dhe departamentet e fakultetit.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Konstatohet se institucioni zhvillon takime pune, në vijimësi, lidhur me analizën dhe informimin për programet e studimit, për arritjet akademike të studentëve duke përfshirë në këto mbledhje studentë, pedagogë dhe personelin mbështetës ²⁵⁸ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

²⁵⁶ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 4, Plani Strategjik i Zhvillimit të FSHHKGJGJ", ASCAL, Dok. nr.15. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁵⁷ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 4.1, Draft Plani Strategjik i Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë", ASCAL, Dok. nr.16. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁵⁸ Kolegji Universitar "LOGOS", FSHHKGJ, DPP, "Aneksi 30, Raporte Vjetore të monitorimit dhe Sigurimit të Cilësisë", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Gusht 2021, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është i hartuar mbi bazën e përvojave më të mira të universiteteve perëndimore në fushën e përgatitjes së mësuesve të Arsimit Parashkollor, por dhe trajton filozofi, përmbajtje dhe praktikat më të mira të ideve të Montesorit, si një nga modelet më të mira perëndimore;
2. Departamenti Pedagogji-psikologji, që mbulon programin e studimit, ka një staf profesional dhe të mirëkualifikuar për zbatimin në mënyrë të efektshme të tij;
3. Institucioni ka infrastrukturë fizike, ndihmëse, platformë online që lehtëson zbatimin e programit, por dhe kërkesat e nevojat e studentëve. Rezulton se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ;
4. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor ka kapacitet infrastrukturor dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve të programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, duke përmbushur kështu standardet e kapacitetit infrastrukturor për student;
5. Institucioni ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi të ndryshme për krijimin e kushteve për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike të cilat janë thelbësore për këtë program studimi;

b. Pika të dobta

1. Mosha relativisht e re e institucionit;
2. Pamjaftueshmëri me literaturë europiane të 3-4 viteve të fundit, e cila duhet të jetë e lidhur ngushtë me programin e studimit;
3. Numër i vogël i bashkëpunimeve dhe i mobiliteteve në funksion të programit;

Rekomandime


1. Rekomandohet që Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë të hartojë dhe të zbatojë një strategji të mirëmenduar dhe me plan veprimi, konkret dhe efektiv për rritjen e numrit të studentëve në programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”;
2. Rekomandohet që Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë, referuar edhe VKM nr. 418, datë 10.5.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”, të plotësojë të paktën numrin minimal prej 7 PAE;
3. Rekomandohet që institucioni të pasurojë bibliotekën fizike dhe atë online me publikime shkencore dhe metodologjike të 3-4 viteve të fundit që lidhen me programin e studimit Mësuesi në Arsimin Parashkollor;
4. Rekomandohet që institucioni të afishojë në këndet përkatëse të fakultetit, pranë departamenteve, në mjedise publike dhe gjithashtu të publikojë në faqen e webit të tij, sipas

b. Weak points

1. Relatively young age of the institution;
2. Insufficiency with European literature of the last 3-4 years, which should be closely related to the study program.
3. Small number of collaborations and mobilities in function of the program;

Recommendations

1. It is recommended that the Department of Pedagogy and Psychology have to design and implement a well-thought-out strategy with a concrete and effective action plan for increasing the number of students in the Bachelor study program in "Teacher for Preschool Education";
2. It is recommended that the Department of Pedagogy-Psychology, also referred to DCM no. 418, dated 10.5.2017 "On standards, criteria and procedures for the opening, reorganization, division, merger or closure of higher education institutions and their branches", to meet at least the minimum number of 7 full time faculty members;
3. It is recommended that the institution to enrich the physical and online library with scientific and methodological publications of the last 3-4 years related to the study program Teacher in Preschool Education;
4. It is recommended that the institution have to put in the respective environments of the faculty, near the department, in public places and also to publish on its website, complete and detailed information regarding the criteria and procedures for the academic progress of students and transition from one academic year to another;
5. It is recommended to complete the Regulation of the FHSLC and the Regulation of the Department regarding the position of the Coordinator of the Study Program;
6. It is recommended that the name of the FHSLC to be: Faculty of Humanities Sciences and Education (since according to UNESCO the field of linguistic sciences is part of the humanities) or to establish the Faculty of Education (as provided in the Strategic Development Plan of UC "LOGOS" mentioned above at this point);
7. It is recommended that the institution enrich the university academic offer with a Bachelor program in Primary Education Teacher, as well as second cycle master programs in this study field;



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X